INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

**Seria e kërkimeve politike**
BOTIM I VEÇANTË

# REFORMIMI I SISTEMIT ZGJEDHOR NË KOSOVË

## Punim diskutues

Prishtinë, qershor 2005
Ribotim

KIPRED

**INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE**

**Seria e kërkimeve politike**
BOTIM I VEÇANTË

# REFORMIMI I SISTEMIT ZHGJEDHOR NË KOSOVË

## Punim diskutues

Prishtinë, qershor 2005
Ribotim

Ky projekt është përkrahur nga KIPRED/Olof Palme International Center, FDI/USAID dhe Rockefeller Brothers Fund, SHBA.

Mendimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdo mendimet e KIPRED-it apo të Forum-it.

Ky hulumtim është përpiluar nga: Leon Malazogu dhe Ilir Dugolli

Copyright © 2005 KIPRED, Leon Malazogu dhe Ilir Dugolli. Botimi i parë 2003. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij punimi nuk mund të ribotohet, përdoret apo të përcillet në çfarëdo forme qoftë përmes mjeteve elektronike, mekanike, fotokopjimit, inçizimit apo të tjera, pa pëlqimin paraprak të botuesit.

KIPRED

Ju lutem kontaktoni:
KIPRED – Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtina, Kosovo (UNMIK)
Tel. & faks.: +381 38 555 887
info@kipredinstitute.org

## Përmbajtja

1. Hyrje
Rekomandim për debat publik
2. Qëllimi I Punimit
3. Një Herë, Mirë, Dhe Me Përfshirje Të Të Gjithëve
4. Tradita Demokratike Në Kosovë
5. Sistemi Zgjedhor Aktual
Roli i bashkësisë ndërkombëtare dhe vendet e rezervuara
Të kosovarizohen zgjedhjet!
6. Kriteret Për Vlerësimin E Sistemit Zgjedhor
7. Analizimi I Efekteve Në Sistemin Politik
Gjasat për qeveri të papërgjegjshme dhe të dobët
Mungesa e opozitës efektive
Zhgënjimi me tërë klasën politike
Listat e mbyllura dhe hierarkia më e theksuar brenda partive
Mungesa e përfaqësimit gjeografik dhe llogaridhënia individuale
Cenimi i parimit "një person – një votë"
Rënia e vazhdueshme e numrit të votuesve
8. Ku Dëshiron Të Arrijë Kosova?
Vlerat të cilat do të duhej të mbrohen dhe nxiten përmes sistemit zgjedhor
Katër faktorët relevantë të cilët mund të jenë objekt diskutimi
9. Çfarë Duhet Të Debatojnë Liderët Politikë Dhe Opinioni Publik?
Fuqia e qeverisë
Llogaridhënia
Përfaqësimi gjeografik
Si të arrihet zhvillimi i fushatave për çështje konkrete?
Përfaqësimi i pakicave
Formësimi dhe kohezioni përbrenda partive politike
Trendet e pjesëmarrjes në zgjedhje
Të zhvendosurit dhe diaspora
Përmasat mesatare të njësive zgjedhore
Pragu minimal
10. Mbrojtja E Pakicave
Vendet e rezervuara
Minimizimi i votave të humbura
Mbajtja e vendeve të rezervuara për pakicat joserbe
Garancat kushtetuese dhe mjetet tjera që mund të jenë në dispozicion për pakicat
11. Sfidat Për Një Përfaqësim Gjeografik: Njësitë Zgjedhore

Shumëanëtarëshe
12. Sfida E Listave Të Hapura Dhe Përfaqësimi Gjinor
13. Çfarë Sistemi Kosova Synon Në Parim?
14. Variacionet E Rekomanduara
Mangësitë
Përparësitë
15. Sa Do Të Kushtojë?
16. Sygjerimet Përfundimtare

Shtojcat
A. Palët e interesuara
B. Shkurtesat
C. Dokumente relevante për zgjedhjet në Kosovë
D. Burime nga interneti
Burimet dhe materiale të rekomanduara për sistemet zgjedhore

Shënime

## Përmbledhje

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV) janë themeluar para disa kohësh si institucione qeverisëse, të cilat përfaqësojnë popullin e Kosovës dhe veprojnë nën mandatin e Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Pavarësisht nga legjitimiteti i tyre demokratik, kompetencat e IPV-ve për ta shprehur vullnetin e popullit në proceset vendimmarrëse politike janë të kufizuara dhe i nënshtrohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, (PSSP). PSSP-ja ka "pushtetin" kyç për çështjet kryesore, siç janë punët e jashtme, drejtësia, rendi publik dhe zhvillimet makroekonomike.

Megjithatë, IPV-të, si përfaqësuese legjitime të popullit të Kosovës, kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për shqyrtime, vlerësime, analiza dhe kritika lidhur me vendimet politike të PSSP-së, edhe nëse çështjet në fjalë janë nën kompetencë të tij. Kapaciteti për ta mbikëqyrë me efektshmëri veprimtarinë politike të PSSP-së kërkon, pikë së pari, një nivel të lartë të informacioneshve dhe një vullnet politik për ta bërë këtë. Ky dokument synon arritjen e synimit të parë nga këta të dy.

Situata e tanishme ekonomike, jo aq shpresëdhënëse, duhet të shkëputet nga mbeturinat e quajtura "prona dhe ndërmarrje shoqërore", nëse mëton të zhvillohet në një ekonomi të tregut të lirë të efektshme dhe të vetëqëndrueshme. Prandaj, sikur edhe në vendet e tjera paskomuniste, fjala kyçe edhe këtu është "privatizimi". Meqë tashmë ekziston një përvojë lidhur me privatizimin, nuk kemi nevojë "ta rizbulojmë Amerikën". Por, në fakt, ky privatizim duhet t'u përshtatet kushteve të Kosovës, duke marrë parasysh faktorët e veçantë politikë, historikë, ekonomikë dhe shoqërorë, dhe sidomos çështjen e hapur të statusit përfundimtar politik të Kosovës. Megjithatë, vështirësitë me të kuptuarit e natyrës ligjore të pronës shoqërore u kanë lënë shumë vend spekulimeve teorike lidhur me atë se kush është zotëruesi i njëmendtë i pronave shoqërore. Kjo gjë, në fund, nuk e ndihmon zgjidhjen e problemit. Prandaj, prona shoqërore mbetet ende një mister për zyrtarët ndërkombëtarë të përfshirë në këtë çështje.

Pas ushtrimit të autoritetit mbi ndërmarrjet shoqërore (NSH) nga autoritetet komunale, në bashkëpunim me zyrtarë të UNMIK-ut, komunat përherë e më shumë filluan të mënjanohen nga funksioni fillestar mbikëqyrës që kishin. Paaftësia e Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë (DTI) për ta ushtruar me efektshmëri kontrollin dhe menaxhimin mbi ndërmarrjet shoqërore, rezultoi me një vakuum ligjor. Ky vakuum ligjor u keqpërdor nga ndërmarrjet shoqërore, të cilat filluan, – megjithëse pa qartësimet e duhura ligjore - t'i japin pronat me qira. Tentimet e para për rigjallërimin e ekonomisë së Kosovës nëpërmjet komercializimit, duke synuar ta tërhiqnin kapitalin vendor dhe atë të huaj, dështuan. Aktualisht, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është organi

i ngarkuar për t'i administruar ndërmarrjet publike dhe shoqërore. Mandati i AKM-së përfshin, po ashtu, edhe privatizimin e pronës shoqërore, nëpërmjet të së ashtuquajturës "procedurë e amputimit" (spin-off). Në anën tjetër, mandati (aktual) i AKM-së nuk lejon privatizimin e pronave të paluejtshme shoqërore (trojet dhe objektet), të cilat janë të vetmet prona të vlefshme të këtyre ndërmarrjeve dhe të cilat aktualisht nuk po përdoren për prodhim industrial, por vetëm për qëllime të dhënies me qira. Pa privatizimin e këtyre pronave, kurrfarë privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nuk do të ishte frytdhënës.

Privatizimi i pronave të paluejtshme shoqërore është një akt shumë më i komplikuar sesa privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Interesat komerciale dhe ekonomike janë të vetmet aspekte që duhet të merren parasysh. Aspektet e tjera të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen, janë kthimi i pronarëve të shpronësuar më parë, interesat e komunës dhe ato të administratës lokale. Çdo përpjekje serioze për privatizimin e pronës së paluejtshme shoqërore duhet të koordinohet me të tri aspektet e lartpërmendura. Modeli i propozuar në këtë dokument është ai gjerman "Treuhand", i cili ishte autorizuar që ta privatizonte të ashtuquajturën "Volkseigentum" (pronë e popullit), e cila – si koncept – është shumë e ngjashme, nëse jo edhe identike, me pronën shoqërore në Kosovë. Megjithatë, dokumenti që keni në dorë mund të shërbejë si bazë për mendime dhe shqyrtime të mëtejme në këtë drejtim dhe zgjidhjet e paraqitura në të nuk duhet të trajtohen doemos si të vetmet zgjidhje.

Përzgjedhja e sistemit zgjedhor është një ndër vendimet më të rëndësishme për çdo demokraci. Megjithatë, historia tregon pak shembuj kur sistemet zgjedhore janë përcaktuar në mënyrë të vetëdijshme dhe të qëllimshme. [1]

## 1. HYRJE [2]

Demokratizimi i Kosovës mund të jetë aq i kënaqshëm sa është edhe vetë kompromisi i arritur përmes Rezulotës 1244 së Këshillit të Sigurimit, e cila përcakton shtyllën juridike të asaj se çfarë mund apo nuk mund të jetë Kosova. Një status i qartë i Kosovës do të ishte mënyra më e shpejtë për zgjidhjen e disa prej çështjeve më të rëndësishme, mirëpo për shkaqe politike, tani për tani kjo nuk mund të arrihet. Kjo nuk do të thotë që Kosova e ka arritur nivelin më të lartë të demokratizimit që mund të arrihet pa zgjidhjen e statusit. Katër vite kanë kaluar nga përfundimi i luftës. Kriza humanitare ka kohë që është zgjidhur. Për këtë arsye autoritetet në Kosovë duhet të punojnë në drejtim të formësimit dhe kristalizimit të parimeve demokratike në paralelisht me punën drejt zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës.

Edhepse ka shumë pengesa për demokratizimin e mëtejmë të Kosovës, ky punim argumenton se sistemi zgjedhor i tanishëm paraqet pengesën kryesore për të arritur një nivel më të avansuar të demokracisë. Përmirësimi i sistemit zgjedhor mund të sjellë përparime të mëtejme të drejtave individuale dhe grupore, si dhe të rrisë legjitimitetin dhe përgjegjshmërinë e gjithmbarshme demokratike. Meqë Kosova do të paguajë për zgjedhjet në vitin 2004, sistemi i tanishëm duhet të zëvendësohet me një sistem zgjedhor që është i paguar e i menaxhuar nga kosovarët dhe të cilin ata e ndjejnë si të tyre.

Ka shumë të atillë që thonë se fare nuk ia vlen të flitet për sistem zgjedhor deri sa personat e zgjedhur nuk kanë pushtet të vërtetë për të ndikuar në realitetin ekzistues. Fuqia e organit që zgjedhet është në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me rëndësinë e zgjedhjeve siç vërehet nga qytetarët dhe me fuqinë e tyre votuese. Siç theksohet nga ICG, "në rast se shpesh ndjehet dora e rëndë e PSSP-së, politikanët kosovarë kurrë nuk do të fitojnë ndjenjën e përgjegjësisë e cila mund të vijë vetëm përmes pushtetit të vërtetë" (2001: 18). Në këtë kontekst, shumë kosovarë e drejtojnë gishtin kah administrata e UNMIK-ut si pjesë e problemit. Edhepse kosovarët e kanë pranuar misionin ndërkombëtar me mirënjohje përkundër pushtetit të jashtëzakonshëm të PSSP-së, ka lindur domosdoshmëria për të filluar me vënien e themeleve të një demokracie të shtyrë nga vetë vendorët dhe që u jep llogari qytetarëve të vet, e sidomos në fazën kur kompetencat kanë filluar të barten gjithmonë e më shumë tek vendorët.

Në përgjithësi, sistemi zgjedhor aktual: (a) ka zbehur vijat ndërmjet partive shqiptare dhe nuk stimulon profilizimin ideologjik dhe joshjen e grupeve specifike të votuesve në përputhje me programin partiak, (b) nxitë tej mase partitë dhe kompromiset etnike, (c) eliminon gjasat për një opozitë të fortë, (d) thekson hierarkinë partiake, (e) lë disa

komuna pa kurrfarë përfaqësimi dhe dobëson lidhjen ndërmjet deputetit dhe votuesit, (f) ofron kanale jo të qarta të llogaridhënies si pasojë e listave të mbyllura, (g) duke qenë i shpallur përmes rregullores, nuk mund të thuhet se qytetarët e ndjejnë këtë sistem si të vetin, kështu që zgjedhjet gëzojnë legjitimitet të kufizuar.

Ky punim nuk përpiqet të diskreditojë sistemin zgjedhor të miratuar në vitin 2000, meqë sistemi në fjalë mund të ketë qenë kompromisi më i mirë duke pasur parasysh një varg rrethanash. Përkundrazi, ky punim avokon se pas tri zgjedhjeve dhe katër viteve të administrimit ndërkombëtar dhe qeverisjes, duhet të rishqyrtohet dinamika politike e cila do ta përcjellë Kosovën edhe pas UNMIK-ut. Qysh në fillim të misionit, OSBE-ja e konsideronte qenësore "të gjejë një sistem të cilin votuesit e kuptojnë dhe e pranojnë, dhe i cili do të mund të vihej në jetë në kohën e zgjedhjeve". "Gjithashtu, duhet pasur parasysh se këto zgjedhje janë për kuvendin e përkohshëm, dhe se sistemi zgjedhor mund të ndryshohet përderisa votuesit, partitë politike dhe administruesit e zgjedhjeve fitojnë përvojë" (2001: 4). Përgjatë vijave të njejta të argumentimit, Reilly dhe Reynolds kanë vëne re se "…sistemi zgjedhor i cili është më i përshtatshmi menjëherë pas përfundimit të konfliktit të brendshëm mund të mos jetë më i miri për menaxhimin afatgjatë të konfliktit" (1999: 1). Rjedhimisht, Kosova duhet t'i rreket një procesi transparent të diskutimit për rishqyrtimin e sistemit e vet zgjedhor.

## *Rekomandim për debat publik*

Në Kosovë ka nevojë për një debat të hapur publik për kulturën politike, vlerat normative dhe sistemin shtetëror të cilin qytetarët e saj synojnë të realizojnë, pavarësisht nga zgjidhja e statusit përfundimtar. Reynolds identifikon katër mënyra të përzgjedhjes së sistemit zgjedhor: përmes trashëgimisë koloniale, me dizajnim të vetëdijshëm, imponim nga jashtë dhe në mënyrë të rastësishme. Mënyra ideale e vendosjes për sistemin zgjedhor është permes dizajnimit të vetëdijshëm, prandaj edhe paraqitet nevoja e përfshirjes në një proces të diskutimit të hapur për rishqyrtimin e sistemit zgjedhor. Debati nuk duhet të përqëndrohet rreth çështjeve teknike të sistemit zgjedhor, por për vlerat demokratike dhe preferencat normative të cilat sistemi zgjedhor tenton t'i nxitë. Siç pohon Donald Horowitz, "Asnjë sistem zgjedhor nuk pasqyron në mënyrë besnike preferencat e votuesve, ndarjet ekzistuese në shoqëri, apo edhe konfigurimin aktual të partive politike. Çdo sistem zgjedhor formëson dhe riformëson këto tipare të ambientit politik dhe secili sistem e bën këtë ndryshe" (1). Pasi që kosovarët të kenë arritur një konsensus për vizionin e tyre, mund të kalohet në diskutime më teknike, me ç'rast sistemi zgjedhor do të formësohej ashtu që të arrijë synimet e dëshiruara. Iniciativa të ndryshme deri më tani kanë prodhuar rezultate të pakta në ngjalljen e këtij debati qoftë edhe në qarqe të kufizuara. Prandaj, duhet bërë përpjekje të reja në nivelin institucional për të siguruar që një dialog i tillë të ngjajë. Dhe më në fund, duhet të përmendet se ky diskutim assesi nuk duhet shikuar si mënyrë që një grup interesi të ngadhënjejë ndaj tjetrit, por për të hapur një debat mbi vlerat e së ardhmes të cilat duhet ushqyer.

## 2. QËLLIMI I PUNIMIT

Në frymën e mirëfilltë të një punimi diskutues që synon të hapë një diskutim të vazhdueshëm, ky punim synon të shtrojë pyetje dhe në të shumtën e rasteve, përpiqet të ofrojë më shumë se një përgjigje të mundshme, duke pasur si të vetmin qëllim stimulimin e komenteve:

(a) Analizojë funksionimin dhe pasojat politike të sistemit zgjedhor aktual dhe të vlerësojë efektet politike afatshkurtra dhe afatgjata që kanë rezultuar nga ky sistem dhe efekte të tjera që mund të vërehen më vonë;

(b) Analizojë marrëdhëniet ndërmjet sistemit zgjedhor dhe dinamikës politike që ka prodhuar sistemi në fjalë;

(c) Analizojë çështjet relevante për krijimin e sistemit zgjedhor;

(d) Të përpiqet të identifikojë një vizion preliminar për sistemin politik dhe vlerat demokratike drejt të cilave Kosova duhet të synojë (qoftë edhe nëse statusi i Kosovës vazhdon të jetë i përcaktuar nga Rezoluta 1244);

(e) Analizojë se çfarë sistemi zgjedhor do të ishte praktik dhe efektiv të kontribuojë drejt arritjes së përmirësimit të sistemit politik;

(f) Ky punim nuk synon që të jetë një analizë gjithëpërfshirëse e të gjitha çështjeve relevante, por vetëm të stimulojë debat. Ky punim analizon vetëm sistemin zgjedhor dhe i lë anash aspektet organizative të zgjedhjeve.[3]

(g) Përfundimisht, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se sistemi zgjedhor ekziston vetëm në kontekst politik, ky punim bën përpjekje për identifikimin e disa variacioneve të sistemit zgjedhor si nxitje më e mirë e llogaridhënies individuale, marrëdhënieve ndërgrupore, qeverisjes së mirë, vendimmarrjes demokratike dhe strukturave të brendshme demokratike.

## 3. NJË HERË, MIRË, DHE ME PËRFSHIRJE TË TË GJITHËVE!

Sipas Arend Lijphart-it, sistemi zgjedhor përfaqëson "një tërësi të rregullave thelbësisht të pandryshueshme, në bazë të të cilave një ose më shumë zgjedhje të njëpasnjëshme zhvillohen në një vend demokratik" (1994: 13). Ndër përkufizimet e tjera të shumta, ndoshta më i thjeshti dhe më i përdoruri është se sistemi zgjedhor është një tërësi e metodave që përcaktojnë "përkthimin" (shndërrimin) e votave në vende përfaqësuese.

Duke qenë se "sistemet zakonisht janë shumë stabile dhe u rezistojnë ndryshimeve" (Lijphart 1994: 52), për të qenë i suksesshëm, hartimi i sistemit zgjedhor duhet të jetë tejet analitik. Vitet e nëntëdhjeta në Ballkan kanë shënuar ndryshime relativisht të shpeshta të sistemeve zgjedhore, me një trend të përgjithshëm të lëvizjes nga sistemet mazhoritare drejt atyre proporcionale. Sidoqoftë, është e rëndësishme që në bal-

lafaqimin me çështjen e përfaqësimit në Kosovë, një vëmendje e madhe t'i kushtohet zbatimit të sistemit që nga fillimi.

Nëse dëshirohet një rishqyrtim serioz i sistemit, ka nevojë që të gjitha palët e interesuara me peshë të përfshihen në një proces shqyrtimi e diskutimi. Sipas Roth-it, rëndësia e këtij procesi është gjithashtu se ju ndihmon qytetarëve të realizojnë të drejtën e tyre për pjesëmarrje në qeverisje, duke siguruar një proces zgjedhor që është më i lirë dhe më efikas, dhe si i tillë, të bëjë të mundur një pasqyrim më të drejtë të dëshirave të trupit zgjedhor, dhe rrjedhimisht të përmirësojë pretendimin e autoriteteve për legjitimitet (5).

Në vitin 2000, bashkësia ndërkombëtare vendosi për sistemin zgjedhor që konsiderohej si zgjidhja më e mirë për atë kohë duke pasur parasysh një varg rrethanash specifike në Kosovë. Pas zgjedhjeve të kaluara, entitete të ndryshme politike dhe qytetarë kanë shprehur pakënaqësitë e tyre me sistemin zgjedhor apo me çështje të tjera të ndërlidhura. Pesha e sistemit zgjedhor nuk duhet nënçmuar duke qenë se ajo ndikon në të gjitha aspektet e jetës politike të një vendi. Meqë sistemi zgjedhor i Kosovës është dizajnuar në këso rrethana, është me rëndësi thelbësore për paqen e brishtë në Kosovë që të gjitha bashkësitë të pajtohen për një sistem të përfaqësimit politik që do të mundësonte një qeverisje të përgjegjshme dhe bashkëpunim ndëretnik.

Gjithashtu, natyra teknike e sistemit zgjedhor ngërthen në vete shumë kurtha të përshtatshme për manipulim nga ana e grupeve të ndryshme të interesit dhe potencialisht mund të krijojë një atmosferë konflikti. Ilirjani duke e përmbledhur argumentimin e Lijphart-it (1990) pohon se sistemi zgjedhor paraqet elementin më të manipulueshëm të sistemit politik. Po ashtu, edhepse ligjet zgjedhore janë të pamjaftueshme për të garantuar jetësimin e stabilitetit dhe të qeverisjes së mirë, ligjet zgjedhore të përpiluara dobët mund të thellojnë ndarjet shoqërore dhe të keqësojnë konfliktet (Ilirjani). Ngjashëm, Reilly dhe Reynolds pohojnë se "zgjidhja optimale për menaxhim të suksesshëm të konflikteve varet nga disa faktorë të identifikueshëm, specifikë për vendin e caktuar, duke përfshirë këtu mënyrën dhe shkallën e politizimit të grupeve etnike, përmasat e konfliktit dhe shpërndarjen demografike dhe gjeografike të grupeve etnike (Reilly and Reynolds 1).

Reformimi i ligjit zgjedhor ka qenë gjithashtu një ndër përfundimet e dala në konferencën e organizuar nga NDI, me ç'rast është potencuar domosdoshmëria "për reformimin e ligjit zgjedhor me qëllim të sigurimit të një përgjegjshmërie të drejtpërdrejtë të të zgjedhurve karshi qytetarëve dhe për një përfaqësim më demokratik (lista të hapura, ndarja e njësive zgjedhore)" (2003: 2). Përfundimisht, është me rëndësi të rishqyrtohet sistemi zgjedhor, të analizohen opcione të ndryshme me kujdes dhe të përfshihen të gjitha palët me peshë: partitë politike, shoqëria civile, grupet etnike dhe bashkësia ndërkombëtare.

## 4. TRADITA DEMOKRATIKE NË KOSOVË

Për shkaqe historike dhe rrethanore, Kosova e pas-luftës ka ngecur sa i përket demokratizimit. Studimi i demokracisë në Kosovë është një detyrë mjaft dëshpëruese. Kosovarët kurrë nuk kanë vendosur tërësisht për fatin e tyre. Ata kanë qenë objekt i politikave koloniale, më në fund duke iu besuar një kujdestarie ndërkombëtare, që si e tillë vetë nuk është e drejtuar në mënyrë demokratike. Është e kuptueshme se Kosova kurrë nuk ka krijuar ndonjë kushtetutë të veten të cilën do të mund ta implementonte dhe me të cilën do të identifikohej plotësisht. Periudha e vetme e të drejtave politike relative ka qenë ajo ndërmjet viteve 1974 dhe 1989 kur Kosova gëzonte një formë të autonomisë vetëqeverisëse, edhepse kjo nuk ka qenë demokratike dhe ka poseduar një formë të lartë të kontrollit nga ana e Partisë Komuniste. Përvoja tjetër e strukturave kuazi-shtetërore ishte organizimi i zgjedhjeve nga lëvizja e rezistencës në fillim të vitete nëntëdhjetë, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj (duke ofruar me atë rast një sistem zgjedhor të përzier me vende të rezervuara për pakicat).

Si pasojë e konflikteve të cilat kanë zgjatur me shekuj, Kosova trashëgon ndarje të thella etnike. Për shkak të polarizimeve përbrenda dhe ndërmjet bashkësive, shqiptarët dhe serbët vetëm sa i kanë forcuar qëndrimet e tyre sa i përket çështjeve kryesore të historisë së vonshme. Përkufizimi i lojalitetit politik përgjatë vijave të caktuara ngushtë sipas ndarjeve etnike rezulton në mungesë të votave që kalojnë nga njëri kamp në tjetrin dhe të cilat do të mund të josheshin përmes programeve specifike partiake. Si rezultat i kësaj, përkatësitë partiake vendosen në varësi të liderëve të partive më të mëdha, apo në bazë të asaj se kush ka qenë në anën e kujt gjatë luftës së fundit. Rrjedhimisht, ka pak dallime ndërmjet partive dhe mungojnë programet politike të cilat synojnë të joshin grupe specifike të votuesve. Për më tepër, preferencat partiake, si rregull, thehen përgjatë vijave etnike, fetare dhe gjuhësore. Në këtë fazë, çështjet më të rëndësishme ende mbesin të ndjeshme për t'u prekur. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim do të ishte krijimi i sistemit zgjedhor të cilin të gjithë kosovarët do ta ndjenin si të vetin.

## 5. SISTEMI ZGJEDHOR AKTUAL

Sistemi zgjedhor aktual është shpallur nga zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) pasi që të jetë formuluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në formën të draft-rregullores dhe të jetë kthyer nga Zyra Ligjore në Nju Jork. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është "përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në Kosovë". KQZ është emëruar nga PSSP, megjithëse thuhet se puna e Komisionit është "teknike dhe profesionale" (OMiK). Sa i përket zgjedhjeve për Kuvend, sistemi zgjedhor aktual e trajton Kosovën si një njësi zgjedhore me shpërndarje propocionale të vendeve të përfaqësuesve. Formula Sainte-Lague është përdorur për të llogaritur shndërrimin e votave në vende përfaqësuese. Kuvendi ka 120 vende, prej të cilave 20 janë të rezervuar për bashkësitë jo-shqiptare. "Këto përfshijnë dhjetë vende për bashkësinë sërbe, katër

për romët, ashkalitë dhe egjiptasit, tre për bashkësinë boshnjake, dy për bashkësinë turke dhe një për bashkësinë gorane. Këto vende u shtohen vendeve të tjera të cilat bashkësitë mund t'i kenë fituar nga 100 vendet në Kuvend, e për të cilat votojnë të gjithë votuesit (OMiK "Summary…" 4). Listat e kandidatëve janë të mbyllura, duke nënkuptuar se votuesit votojnë për partinë politike dhe jo për kandidatin e caktuar. Gjithashtu, sistemi paraqet një kusht gjinor me ç'rast listat e kandidatëve duhet të kenë së paku 1/3 femra. Nuk parashihet kurrfarë pragu minimal për përfaqësim në Kuvend për cilatdo entitete politike. Në zgjedhjet e fundit parlamentare më 2001, Misioni i OSBE-së në Kosovë, që ka udhëhequr zgjedhjet, ka pasur rreth 1.700 vendvotime, 550 qendra votimi dhe 750 votues për një vendvotim në vitin 2001.

| Data | Lloji i zgjedhjeve | Sistemi | Vendet e rezervuara | Pragu | Përpjestimi votues/përfaqësues |
|---|---|---|---|---|---|
| 28 tetor 2000 | Lokale | Proporcionale, lista të hapura | Asnjë; zyrtarë minoritarë janë emëruar më vonë | Jo | 700-2200* |
| 17 nëntor 2001 | Kuvendit | Proporcionale, një njësi zgjedhore, lista të mbyllura | 10 për serbë; 10 për pakicat tjera | Jo | Përafërsisht: 8300 |
| 26 tetor 2002 | Lokale | Proporcionale, lista të mbyllura | Asnjë | Jo | 160-3044 (mesatarja për pakica: 465) |

*Zgjedhjet në Kosovë 2000-2002*

*Përpjestimi votues/përfaqësues nga zgjedhjet në vitin 2000 nuk merr parasysh në llogaritje komunat ku serbët përbëjnë shumicë sepse pjesa më e madhe e popullatës nuk ishte e regjistruar, prandaj nuk mund të nxjerren të dhëna të sakta.

## *Roli i bashkësisë ndërkombëtare dhe vendet e rezervuara*

Sistemi zgjedhor aktual vë prioritet në mundësimin e hyrjes së përfaqësuesve politikë të pakicave në organe ligjvënëse dhe jo aq në prodhimin e institucioneve të mirëfillta demokratike. Nuk do të thotë që këto dy gjëra përjashtojnë njëra tjetrën, por kompromiset e bëra për identifikimin e "grupeve" deri më tani e kanë parandaluar zhvillimin e institucioneve të mirëfillta demokratike. Vetë përfshirja pakicave i ka dhënë një shtytje të fuqishme kredibilitetit të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, por kjo vetvetiu nuk ka pasqyruar vlera demokratike.

Pjesëmarrja e pakicave ka qenë rezultat i presionit dhe i lëshimeve të drejtpërdrejta të bashkësisë ndërkombëtare aq sa edhe rezultat i sjelljes bujare të shumicës. Grupi Ndërkombëtar i Krizave konkludoi se "preokupimi perëndimor me garantimin e pjesë-

marrjes sërbe ishte edhe i panevojshëm edhe kishte efekt të kundërt" (2001: 13). Për më tepër, përfaqësuesit e pakicave të emëruar nga PSSP-ja në kuvendet komunale të vitit 2000 kurrë nuk kanë marrë vulën e legjitimitetit prej votuesve.

Dhjetë vendet shtesë të rezervuara për serbët nuk kanë dhënë rezultatete të cilat është synuar të japin. Vlen të përmendet se një numër i politikanëve kosovarë kanë menduar se kjo është një kuotë minimale që duhet të plotësohet dhe jo vende shtesë për pakicat. Më vonë, kosovarët janë pajtuar me vendet e garantuara për serbët meqenëse numri i tyre në Kuvend nuk ka qenë aq i lartë sa për të luajtur një rol vendimtar në vendimmarrje. Ngjashëm me përvojën e vendeve të ndara në vende të ndryshme, kjo mund të ketë pasur efekt më të dëmshëm në opinionin publik në tërësi se sa që ka pasur efekt pozitiv në forcimin e bashkësisë sërbe. Një punim i mëhershëm i KIPRED-it konkludoi se duke qenë se Qeverisë së Kosovës i mungojnë kompetencat në lëminë e policisë, gjyqësisë, makroekonomisë dhe lëmitë e tjera me peshë, roli kryesor i vendimmarrësve vendorë, për sa i përket marrëdhënieve ndëretnike, është krijimi i një klime të favorshme (KIPRED 2003: 31). Si privilegj ndaj një pakice që ka udhëhequr një sistem aparteidi, vendet e rezervuara kanë zvogëluar hapësirën politike të politikanëve kosovarë për të ndikuar pozitivisht marrëdhëniet ndëretnike për shkak të perceptimit nga bashkësia shqiptare si padrejtësi.

## *Të kosovarizohen zgjedhjet!*

Në prill të vitit 2002, një deputet ka inicuar bartjen e zgjedhjeve në duar të institucioneve vendore, duke kërkuar që ligji zgjedhor të miratohet nga Kuvendi. Personalitete të ndryshme politike kanë deklaruar se Kosova është e gatshme të paguajë për zgjedhjet e veta, se bashkësia ndërkombëtare nuk do të duhej të shpenzojë shumë dhe të nxjerrë rregullore sa herë që ka zgjedhje në Kosovë, dhe rrjedhimisht procesi i zgjedhjeve duhet të "kosovarizohet" përmes nxjerrjes së ligjit zgjedhor (Gashi 2002: 3; Camaj 2002: 1). Jo të gjitha partitë janë pajtuar me këtë. Partitë më të vogla janë pajtuar për "kosovarizimin" e zgjedhjeve, por për shkak të mospajtimeve ndërmjet partive, kanë parapëlqyer që kjo t'i mbetet OSBE-së edhe për zgjedhjet e ardhshme.

Më 2002, PSSP ka autorizuar krijimin e Grupit Punues të Zgjedhjeve (GPZ), një organ joformal i emëruar nga PSSP-ja dhe në shërbim të tij. Anëtarë të ndryshëm të GPZ-së kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me ritmin e punës së grupit, mungesën e përkushtimit të demonstruar nga një numër pjesëmarrësish dhe vështirësitë për të arritur konsensus.

Përkundër përpjekjeve të kosovarëve për bartjen e administrimit të zgjedhjeve tek organet ligjvënëse vendore, PSSP ka shpallur se zgjedhjet mbesin nën juridiksionin e administratës së Kombeve të Bashkuara. Si rezultat i kësaj, ka të tillë që mendojnë që GPZ-ja është krijuar me vetëdije se do të dështojë. Gjithashtu, ka edhe të tillë që kanë shprehur frikën se PSSP-ja dëshiron të paraqesë përpjekjet e kosovarëve si një dështim për të mundur në këtë mënyrë të argumentojë se sistemi zgjedhor nuk duhet ndryshuar.

Një punim i prezentuar në seminarin e OSBE-së mbi sistemin zgjedhor në Kosovë thekson se prania e madhe ndërkombëtare në Kosovë është e arsyeshme vetëm nëse kjo ndihmon që bashkësia sërbe të perceptojë procesin si legjitim. Por, asnjë arsyetim teknik nuk mund të shërbejë si mbështetje për pohimin se kosovarët nuk munden vetë të organizojnë zgjedhjet e tyre. Në të njejtin punim thuhej se "nëse vendet pas konflikteve, të sëmuara rendë nga analfabetizmi dhe pa ndonjë përvojë në zgjedhje – siç ka qenë rasti me Haitin dhe Mozambikun – kanë mundur të organizojnë zgjedhje të pranueshme me ndihmë të jashtme teknike, do të ishte vështirë të argumentohej se, për shkaqe teknike, nuk është e mundur të kenë zgjedhje të menaxhuara nga kosovarët, me kusht që ndihma e nevojshme teknike të jetë bërë e disponueshme" (OSBE "The choice …" 15-16).

Në anën tjetër, Andrew Caldwell, udhëheqës i njësisë së OSBE-së për tranzicionin juridik të zgjedhjeve ka deklaruar se bashkësia ndërkombëtare duhet të ruajë praninë e vet të fuqishme, por se autoriteti i saj do të duhej të jetë i tillë që të ndihmojë dhe këshillojë e jo të ushtrojë pushtet ekzekutiv. Roli primar i saj do të duhej të jetë bartja e procesit tek vendorët sa më shumë që është e mundur. Rrjedhimisht, ky punim rekomandon se me qëllim të gjetjes së zgjidhjes më të mirë dhe të ndarjes së përgjegjësive, administrata e Kombeve të Bashkuara duhet të bartë çështjet në kompetenca të Kuvendit të Kosovës, edhe pse duke ruajtur një prani me peshë në përpilimin e ligjit zgjedhor (duke e kushtëzuar këtë me konsensusin që do të duhej arritur ndër forcat politike kryesore) dhe në monitorimin e gjithshmbarshëm të procesit të zgjedhjeve.

## 6. KRITERET PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT ZGJEDHOR

"Sistemet zgjedhore duhet qëndisur sa më afër asaj çfarë dëshirojnë të arrijnë autorët e tyre. Kuptohet se, në shumicën e rasteve, ata të cilët formulojnë sisteme të tilla dëshirojnë që sistemi të prodhojë rezultat në favor të interesave që ata parapëlqejnë. Argumenti im është se, ka mënyra të tjera për vlerësimin e sistemeve zgjedhore dhe të zgjidhjeve konkrete të bëra sipas atyre sistemeve. Dhe, sipas të gjitha gjasave, pavarësisht nga qëllimet e autorëve të sistemit, do të ketë pasoja të paparashikuara" (Horowitz 200: 22).

Misioni i OSBE-së në Kosovë vlerëson këtë sistem (proporcional me lista të mbyllura) si të thjeshtë për shkak se është transparent, praktik dhe i qëndrueshëm. Megjithatë, këto nuk janë kriteret e vetme që duhet pasur parasysh kur dizajnohet sistemi zgjedhor. Sistemi aktual duhet vënë edhe përballë kritereve vijuese për të matur se sa i shërben ky sistem qëllimit të vet:

(a) Sa i ka forcuar institucionet demokratike? A ka prodhuar ky sistem forca centripetale të cilat tërheqin në drejtim të kompromisit?
(b) Cila është natyra e procesit politik i cili mëtohet të arrihet përmes këtij sistemi?
(c) A ka nxitur një pjesëmarrje më të madhe politike?

(d) Sa i jep legjitimitet qeverisë? A është ky një sistem që i bën përfaqësuesit të jenë më të përgjegjshëm karshi votuesve të tyre?
(e) A ka sjellë ndjenjë të stabilitetit politik dhe a ka siguruar shtytje për pajtim ndëretnik (brenda dhe jashtë vendit) dhe për parti të cilat i tejkalojnë kufijtë ndëretnikë?
(f) Sa ka arritur që proporcionalisht të shndërrojë votat në vende përfaqësuese? (Përfaqësueshmëria)
(g) A ka krijuar kornizë të qartë ligjore dhe të kuptuar nga të gjithë hisetarët? (Disponueshmëria)

Rrjedhimisht, vlerësimi i akëcilit sistem nuk duhet të përqendrohet vetëm në një numër të vogël kriteresh, sepse ai gjithnjë do të jetë një kombinim i faktorëve të cilët duhet të peshohen përballë qëllimeve të mbarështruara nga të gjithë hisetarët që në zanafillë të procesit.

## 7. ANALIZIMI I EFEKTEVE NË SISTEMIN POLITIK

Si pasojë e statusit të pazgjidhur të Kosovës është i dukshëm problemi se njerëzit nuk janë të përqëndruar në probleme lokale e konkrete, por vetëm në probleme të mëdha, si bie fjala pavarësinë dhe marrëdhëniet me Sërbinë. Megjithatë, në këtë aspekt ka pasur trende pozitive duke qenë se në zgjedhjet e fundit lokale, problemet e përditshme janë theksuar shumë me tepër sesa në zgjedhjet e para lokale në vitin 2000 (Stein 2002). Ngaqë deri tani janë mbajtur tri zgjedhje me radhë, edhe zhvillimi i fushatave zgjedhore është bërë më i disiplinuar. Një sistem i kontrollimit dhe balancimit është vënë në jetë nëpërmes revizionit financiar të partive dhe të kandidatëve, që dëshmon se ka zhvillime pozitive në disa aspekte.

Lista e mëposhtme mbarështron përparësitë kryesore të sistemit, (proporcional me lista të mbyllura) të përdorur deri më tani:
(a) I thjeshtë me parregullsi të pakta (praktik dhe transparent);
(b) Në mënyrë besnike shndërron votat në vende përfaqësuese;
(c) Numër të vogël të votave "të humbura";
(a) E thekson ndarjen e pushtetit më shumë;
(d) Shpenzime relativisht të ulëta (rrjedhimisht konsiderohet si i qëndrueshëm);
(e) Përfaqësim i lartë i pakicave (i dyfisht);
(f) Rregull për përfaqësim gjinor (Kosova aktualisht zë vendin e 12 në botë sipas përqindjes së përfaqësimit të femrave).

Marrë në përgjithësi përparësitë e sistemit proporcional mund të përmblidhen si vijon:

*E para,* Lardayret pohon se sistemi proporcional mëton të lejojë përfaqësim të grupeve ekstremiste, të cilat më pas ushqejnë edhe më shume ekstremizmin politik. Sipas Reynolds-it, sistemi proporcional vetëm sa i ndihmon dëshirës

së partive të pakicave për përfaqësim, në vend se të zgjerojë bazën e tyre zgjedhore.

*E dyta,* sistemi proporcional ka tendencë të nxitjes së kalimit të dallimeve politike në ndarje të thella politike dhe të thellimit të tyre. Të dhënat nga vendet afrikane sygjerojnë se sistemi proporcional ka ushtruar presion ndaj partive që të jenë më pak, në vend se më shumë, përfshirëse në aspektin etnik.

*E treta,* sistemet proporcionale zakonisht prodhojnë qeveri shumëpartiake të cilat i nënshtrohen rrezikut të jostabilitetit dhe të cilat e kanë të vështirë të jetësojnë politika koherente. Ndonëse Lijphart ka argumentuar se qeveritë e zgjedhura përmes sistemit proporcional nuk kanë qenë më pak efektive krahasuar me qeveritë e zgjedhura sipas sistemeve të tjera.

*E katërta,* sistemi proporcional jo vetëm që lejon partite ekstremiste të hyjnë në parlament, por u jep atyre hapësirë të madhe, pasi që ato shpesh e marrin rolin vendimtar në krijimin e qeverive të koalicionit. Reynolds i përgjigjet kësaj duke pohuar se është më i mirë kooptimi në qeveri i partive ekstremiste sesa shtyerja e tyre jashtë kufijve të sistemit.

*E pesta,* Lardeyret thotë se sistemet plurale më shumë se sistemet proporcionale kanë gjasa që të sjellin deri tek lindja dhe forcimi i partive të moderuara, meqë në sisteme të tilla partitë janë të detyruara që pandërprerë të garojnë për joshjen e votuesve të papërcaktuar të qendrës. Reynolds-i i përgjigjet kësaj duke marrë për shembull qeverinë Thatcher në Britaninë e Madhe. (Sidoqoftë, mendoj se ky argument ka të bëjë me votuesin mesatar, i cili nuk qëndron patjetër në qendër të spektrit politik. Kjo do të thotë se qeveria Thatcher do të mund të ishte më afër votuesit mesatar sesa afër votuesit të mesit të spektrit ideologjik) (Ilirjani).

Para se të hudhemi në përfundime për përmirësimin e akëcilës pjesë të sistemit, duhet kushtuar kohë më të madhe analizimit të efekteve pozitive dhe negative. Është me rendësi për të vënë re se veçoritë e tjera pozitive të cilat sistemi proporcional me lista të mbyllura zakonisht i shkakton, në rastin e Kosovës nuk vërehen:

(a) Mundësi për partitë që të prezentojnë lista heterogjene të kandidatëve
(b) Nxitje e zgjedhjes së përfaqësuesve të pakicave
(c) Shtim të gjasave për zgjedhje të kandidateve femra (femrat janë zgjedhur, ndonëse jo për shkak të listave të mbyllura por për shkak të rregullës për përfaqësim prej 1/3);
(d) Kufizim të rritjes së "mbretërive lokale";
(e) Sjellja deri tek një qeveri me efikase.

Karakteristikat e listave të hapura dhe të sistemit mazhoritar diskutohen më poshtë në këtë punim. Pjesa tjetër e kësaj pjese analizon më në detaje efektet të cilat ky sistem i ka pasur në Kosovë gjatë katër viteve të administrimit ndërkombëtar.

Lista e efekteve të përmendura më poshtë pa dyshim se nuk është rezultat vetëm i sis-

temit zgjedhor. Rezultatet zgjedhore nuk shkaktohen vetëm nga sistemet zgjedhore, por edhe nga ndarjet e mëhershme shoqërore, qoftë një apo të shumta, që përfshijnë një apo shumë palë (Horowitz 2003: 21). Megjithatë, çështjet e numëruara më poshtë konsiderohet të jenë ndikuar në masë të madhe nga sistemi zgjedhor.

## *Gjasat për qeveri të papërgjegjshme dhe të dobët*

Sistemi proporcional ka pamundësuar partinë më të madhe të shqiptarëve të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) që të fitojë një shumicë solide, çfarë do të kishin arritur me sistem të shumicës (mazhoritar). Njëzet vendet të cilat Korniza Kushtetuese i lë anash për pakicat, gjithashtu e kanë zvogëluar superioritetin relativ të LDK-së dhe aftësinë e saj për të formuar qeveri koalicioni me pak forca të tjera politike. Si rezultat i kësaj, partia në fjalë është detyruar që këtë ta bëjë së bashku me dy partitë e mëdha të shqiptarëve të Kosovës, Partinë Demokratike të Kosovës dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Për shkak të domosdoshmërisë për negociim të vazhdueshëm dhe të nevojës për marrje të konsensusit nga entitetet e koalicionit, qeveria është e brishtë dhe në rrezik të përhershëm të kolapsit. Këtu sidomos vijnë në shprehje edhe dallimet personale ndërmjet liderëve që qëndrojnë diametralisht kundër njëri tjetrit.

Rrjedhimisht, qeveria mund të jetë e fuqishme vetëm nëse tri partitë më të mëdha merren vesh në shpërndarjen e të mirave dhe tejkalojnë dallimet thelbësore në mes tyre. Megjithatë, një koalicion i gjerë i formuar mbi këtë bazë rezulton në një organ ligjvënës që ka opozitë të dobët, dhe që ka gjasa të nxjerrë një qeveri që nuk është aq e përgjegjshme përballë qytetarëve dhe me rrezik potencial që në afat të gjatë të humb legjitimitetin e saj. Meqë politika kosovare kryesisht përcaktohet nga aspektet lokale dhe rajonale, këto dobësi nuk janë domosdo të pranishme në të gjitha komunat. Sipas Horowitz-it, "koalicionet të cilat krijohen pas zgjedhjeve vetëm sa për të bërë qeverinë prej 50% plus një, mund të tregohen të brishta posa paraqiten çështje etnike ndarëse. Prandaj, për qëllime të pajtimit ndëretnik, pyetja është se si ndikon sistemi zgjedhor në kalkulimet parazgjedhore të partive politike dhe të politikanëve (2003: 9). Ky sistem zgjedhor nuk ofron asnjë nxitje për koalicione parazgjedhore. Partitë nuk janë të nxitura të zbusin retorikën e tyre gjatë fushatës, gjë që u mundëson partive ekstremiste që të sjellin mendimet e tyre në Kuvend pa u shqetësuar paraprakisht për atë se a duhet të hyjnë në koalicion apo jo.

## *Mungesa e opozitës efektive*

Edhepse kosovarët janë të lumtur me imazhin e unitetit dhe me faktin se të tri partitë më të mëdha janë në qeveri, kjo vjen në llogari të mungesës së opozitës si alternativë. Opozita është efektive vetëm nëse paraqet një alternativë karshi qeverisë ekzistuese. Në Kosovë, pesë grupet më të mëdha parlamentare janë në qeveri, duke lënë në opozitë vetëm tri partitë me nga një përfaqësues në Kuvend. Tri vende të përfaqësimit në Kuvend nuk mund të shërbejnë si alternativë e qeverisë së mbështetur nga 117 deputetë, prandaj edhe nuk mund të flitet për ekzistim të opozitës në rrethana të tilla.

E kuptueshme, se mungesa e opozitës nuk shkaktohet vetëm nga sistemi zgjedhor, ndonëse, siç është pohuar më lart, sistemi zgjedhor dhe vendet e rezervuara kanë pasur ndikim të dukshëm në këtë rast.

Mungesa e një opozite të zëshme gjithashtu u mundëson partive në qeveri që të ndajnë përfitimet e qeverisjes dhe nëse kjo dukuri nuk paraqitet, kjo ndodh vetëm për shkak të vullnetit të mirë. Kjo mund të ketë zvogëluar tensionet ndërmjet partive, por një stabilitet i tillë e pamundëson vëzhgimin reciprok si mënyrë për parandalimin e keqpërdorimeve. Përmasat se sa ka ndodhur kjo në Kosovë do të bëhen të qarta vetëm gjatë viteve të ardhme. Për shkak të vendeve të rezervuara, përfaqësimi i pakicave në Kuvend gati arriti një të katërtën e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Siç kemi përmendur më lart, si pasojë e tensioneve etnike, LDK-ja ka pasur për opcion të vetëm krijimin e qeverisë së bashku me tri të katërtat e vendeve të mbetura. Matematikisht, ka pasur hapësirë për koalicion që në të njejtën kohë do të kishte ruajtur një opozitë të konsiderueshme, dhe dikush mund të pohojë se koalicioni i gjërë ka qenë më shumë rezultat i pozitave të partive sesa i vetë sistemit si të tillë. Megjithatë, është me rëndësi të vihet re se për shkak të dallimeve rrënjësore me pakicën sërbe sa i përket ardhmërisë së Kosovës, LDK-ja është shtyer të bashkohet me partinë e dytë sipas numrit të votave me qëllim të arritjes së shumicës prej 61 vendeve të nevojshme, përkundër raporteve jo të mira ndërmjet tyre. Duke qenë se LDK-ja nuk do të kishte qenë në gjendje që të themelojë qeverinë së bashku me partinë e tretë të shqiptarëve të Kosovës, AAK-në, e cila pretendonte të jetë e pozicionuar në qendër, ka qenë krejtësisht e natyrshme që edhe kjo parti t'i bashkangjitet koalicionit, duke formuar kështu një koalicion edhe më të gjerë.

## *Zhgënjimi me tërë klasën politike*

Mund të argumentohet se faktorët kryesorë që do të shërbejnë si kriter për vlerësimin e suksesit apo dështimit të klasës politike do të jenë rrethanat politike dhe aftësia për të realizuar pavarësinë e premtuar. Në rast se kjo nuk arrihet në formë të plotë apo nëse nuk arrihet me kohë, Kosova mund të përballet me rënie të vazhdueshme të daljes në zgjedhje, që do të pasqyronte një diskreditim të vazhdueshëm të udhëheqësisë politike vendore. Kjo gjithashtu ndërlidhet me besimin e qytetarëve tek institucionet, partitë politike dhe individët që i udhëheqin këto. Sipas një ankete të zhvilluar në prill të vitit 2003 doli se tre personat më të popullarizuar në Kosovë ishin Kryetari i Kuvendit, Komandanti i Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe Kryeministri i Kosovës, përderisa tre liderët e partive politike ngecën prapa dhe rënia e tyre nga viti 2002 ishte më e theksuar. Është më rëndësi për të vënë re se institucioni i Kryetarit të Kosovës nuk e gëzon një përkrahje të këtillë prandaj edhe përfundimi se përkrahja ndaj dy të tjerëve është rezultat i personaliteteve që i udhëheqin këto dhe jo institucioneve të cilat ata i përfaqësojnë. Është po aq e rëndësishme të përmendet se si publiku i gjerë e bën dallimin ndërmjet partive politike dhe dy institucioneve në fjalë, edhe përkundër faktit se këto institucione shërbejnë për vullnetin e partive politike.

## Listat e mbyllura dhe hierarkia më e theksuar brenda partive

Shumë nga anëtarët e zgjedhur nuk ndjehen mirënjohës ndaj votuesve por ndaj vetë partisë të cilës i përkasin. Kjo mund të jetë e arsyeshme sepse forcon partitë dhe iu mundëson atyre të disiplinojnë anëtarësinë, gjë që në fillim mund të ketë qenë e domosdoshme. Megjithatë, shikuar nga aspekti afatgjatë, një proces i tillë i zbehë marrëdhëniet personale ndërmjet deputetit dhe votuesit dhe nuk i motivon partitë për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt nevojave të votuesve. Në të njejtën kohë, kjo po ashtu pengon decentralizimin brenda-partiak dhe partia nuk zhvillon alternativa efektive brenda radhëve të veta. Anëtarët e zgjedhur (në qendër apo në nivelin komunal) përherë i janë mirënjohës udhëheqësisë qendrore të partisë për faktin që ajo i ka bërë politikanë të respektuar dhe me ndikim duke u ofruar mundësi të shfrytëzimit të pushtetit nëpër mini-mbretëritë e tyre me anë të shpërndarjes së vendeve të punës miqve, anëtarëve të partisë apo të të afërmve. Kandidatët komunalë janë përgjegjës para partisë dhe kjo shpie drejt korrupcionit (Makolli 2002). "Sistemi proporcional me listë kombëtare zakonisht vë pushtet të madh në duart e liderëve partiakë në vendosjen se cilët kandidatë do të kanë vende të favorshme në listat partiake me gjasa më të mëdha për zgjedhje. Kur liderët partiakë të qendrës kanë një pushtet të tillë, konsiderohet se është cenuar sovraniteti i votuesit për të zgjedhur kandidatin, në vend se vetëm të zgjedhë ndërmjet kandidatëve (Horowitz 2003: 6).

Partitë në Kosovë janë mjaft të ngurta dhe hierarkike meqë ato janë modeluar sipas LDK-së (e cila nga aspekti struktural është modeluar ngjashëm me Partinë Komuniste të Jugosllavisë); "listat e mbyllura" e bëjnë edhe më të vështirë reformimin e brendshëm dhe vendimmarrjen demokratike. Për shembull, shumë reformistë brenda LDK-së janë zhgënjyer kur orë të tëra pas votimeve në Këshillin e Përgjithshëm të partisë, Kryetari Rugova me një akt ka vendosur të përfshijë në këshill edhe kandidatët të cilët nuk kishin kaluar në zgjedhjet e brendshme duke rritur dukshëm numrin e përgjithshëm të anëtarëve dhe duke thyer statutin e partisë. Edhe ndër partitë e tjera ka raste të ngjashme, ndonëse jo kaq drastike. Sipas deklaratës së një deputeti, "në rast se dëshiron të bëhesh deputet duhet që të jesh lojal ndaj udhëheqësisë qendrore".

Shënime të tjera statistikore vëjnë në pah hierarkinë brenda partive. Sipas KACI-t, numri më i madh i qytetarëve që e ka ndryshuar lojalitetin partiak para zgjedhjeve të vitit 2001 e ka bërë këtë për shkak të mospajtimit me mënyrën e udhëheqjes brenda partisë (38,9%) (2002 Shtojca). Me këtë është mjaft kundërthënës fakti sipas të cilit 71,5% të votuesve ishin më të kënaqur me liderin e partisë se sa me platformën partiake dhe me listën e kandidatëve për Kuvend (54,7%), gjë që tregon për një nivel më të lartë të varësisë ndaj liderëve përkundër pakënaqësisë me punën e tyre.

## Mungesa e përfaqësimit gjeografik dhe llogaridhënia individuale

Shumë vende theksojnë rëndësinë e përfaqësimit gjeografik, duke qenë se lokaliteti shpeshherë përcakton interesat specifike të bashkësive të ndryshme të shpërndara.

Listat e mbyllura mundësojnë një përfaqësim disproporcional të kryeqytetit në politikën gjithëkombëtare. Një numër i komunave madje as që janë të përfaqësuara në Kuvend, edhepse mesatarisht secila komunë ka katër përfaqësues. Si pasojë e listave të mbyllura, partitë në mënyrë disproporcionale kanë favorizuar kandidatët e regjistruar në Prishtinë dhe kandidatët partia e të cilëve ka humbur dukshëm në vendet prej të cilave vijnë ata. Madje, disa nga deputetët e zgjedhur në ndërkohë mund të jenë zhvendosur në kryeqytet, duke dobësuar kështu edhe më tepër lidhjen gjeografike ndërmjet deputetit dhe votuesit. Kufizimi i votës në parti politike dhe jo për kandidatët gjithashtu e heqë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë dhe e zbehë llogaridhënien e përfaqësuesit të zgjedhur përballë qytetarit.

## *Cenimi i parimit "një person – një votë"*

Marrë në përgjithësi, sistemi tejet bujar ndaj pakicave ka pasur për qëllim që të ekuilibrojë ndikimin e tyre karshi shumicës. Edhe përkundër dyfishimit të numrit të përfaqësuesve të pakicave, si pasojë e shkallës së lartë të shpërpjestimit demografik në krahasim me shumicën (serbët kanë më pak se 10% të numrit të përgjithshëm të banorëve), efektet praktike të vendeve të ndara mbesin tejet të kufizuara, dhe në instancë të fundit praktikisht kjo as që e rrit pushtetin efektiv të pakicave. Kjo masë, edhepse drastike, kurrë nuk ka arritur që të plotësojë nevojat e pakicës më të madhe, gjegjësisht serbëve. Siç kemi pohuar edhe më lart, në vend të forcimit të pozitës së tyre, dyfishimi i vendeve vetëm sa i ka shtyer partitë shqiptare në një koalicion shumë të gjerë. Në rast se hartuesit e sistemit kanë menduar se kjo do t'i detyrojë ata të hyjnë në koalicion me grupet e pakicave, lirisht mund të themi se një gjë e këtillë ka qenë krejtësisht joreale që të pritet. Pozita e serbëve më shumë është mbrojtur përmes kompetencave të jashtëzakonshme të PSSP-së si mjet i fundit, se sa përmes dyfishimit të forcës së tyre në Kuvend. Marrë në përgjithësi, kompromiset etnike afatshkurtra e kanë dëmtuar të kuptuarit e konceptit të demokracisë si proces edhe si rezultat. Horowitz pohon se në parim "sistemi më i mirë zgjedhor është ai i cili në mënyrë të drejpërdrejtë dhe në mënyrë sa më të saktë i shprehë preferencat e votuesve" (2).

Përfaqësimi i fryrë i pakicave është një koncept i pranuar gjërësisht në teori dhe praktikë, ndonëse në rastin e Kosovës ka kritika serioze për mënyrën se si kjo është vënë në jetë. *E para*, nuk ka pasur pjesëmarrje publike dhe kurrfarë diskursi publik në lidhje me sistemin zgjedhor. Sikurse edhe për shumë vendime tjera të administratës së Kombeve të Bashkuara që vendosen larg syve të publikut, edhe ndaj kësaj ka pasur shumë reagime publike. *E dyta*, konsiderohet përgjithësisht se shumica e politikanëve të angazhuar në bisedime, aktualisht kanë menduar se numri prej 20 vendeve të rezervuara për pakicat ka qenë një kuotë që do të mbushej në rast se pakicat nuk arrijnë një nivel proporcional të përfaqësimit. *E treta*, ngjashëm si në shumë vende pas-koloniale, pakicat e privilegjuara në të kaluarën dhe të cilat në periudhën pasuese e gjejnë veten të dëmtuar, sërish privilegjohen si pakicë. Ka pasur zëra të shumtë që pohonin se për dhjetë vite kemi pasur një sistem të sundimit të pakicës në formë aparteidi dhe se pikërisht kjo pakicë tani me sistem zgjedhor është shpërblyer me privilegje të skajshme me qëllim të

kufizimit dhe kushtëzimit të vullnetit të shumicës. *E katërta*, kjo shpie drejt një ritheksimi të ndjenjës së mobilizimit të shumicës me efekte të rritjes së patriotizmit dhe zvogëlimit më të madh të gjasave që të ketë vota të cilat kalojnë kampet etnike. Kjo e zbehë vijën dalluese ndërmjet partive politike shqiptare dhe nuk stimulon profilizimin ideologjik si dhe joshjen e grupeve specifike të votuesve në përputhje me programin. Praktikisht, ky sistem e nxitë funksionimin e partive politike në parim etnik dhe kompromiset ndërgrupore me kritere etnike.

### *Rënia e vazhdueshme e numrit të votuesve, si pasojë e:*

(a) Përfundimit të entuziazmit dhe euforisë së pasluftës. Sipas Caldwell-it, zgjedhjet e vitit 2000 nuk duhet marrë si pikë referimi. Kosova atëherë për herë të parë ishte çliruar nga sundimi jugosllav dhe këto kanë qenë zgjedhjet e para e të lira në periudhën e pasluftës.

(b) Pakënaqësia me tërë klasën politike për shkak të (i) paaftësisë për të zgjidhur statusin përfundimtar, (ii) korrupsionit në përmasa të gjera.

(c) Paaftësia e institucioneve kosovare për shkak të transferit të ngadalshëm të kompetencave nga administrata ndërkombëtare, gjë që zvogëlon peshën e perceptuar të votimit.

(d) Paaftësia për përmbushje të premtimeve nuk jep kurrfarë rezultati të prekshëm në bazë të të cilit do të mund të vlerësohej puna e partive. "Edhe përkundër asaj se të tri partitë kryesore theksojnë përkushtimin e tyre ndaj qeverisjes së shëndoshë, demokratike, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut e kështu me radhë, duke qenë se asnjëra nga to nuk ka histori të qeverisjes, nuk ka bazë në të cilën do të mbështeteshin pohimet në fjalë" (ICG 2001: 8).

Përqindja e pjesëmarrjes së serbëve është ngritur në zgjedhjet e vitit 2002, edhe pse jo në atë shkallë sa ajo e shumicës, duke e legjitimuar vetëm pjesërisht procesin e instaluar nga bashkësia ndërkombëtare në Kosovën e pasluftës.

Gjatë shqyrtimit të këtij punimi, Horowitz pajtohej se veçoritë e lartpërmendura janë "mu ajo çfarë do të pritej nga një sistem i tillë në një shoqëri me kushte si të Kosovës" (Horowitz 2003).

## 8. KU DËSHIRON TË ARRIJË KOSOVA?

Sido që të jetë, mënyra për të shkuar përpara është duke pyetur se cilat janë qëllimet të cilat synohet të nxiten, cilat qëllime parapëlqehen krahasuar me të tjerat, si dhe cilat janë efektet e mundshme të alternativave të ndryshme. Askush nuk mund t'u përgjigjet këtyre pyetjeve pa një analizë gjithëpërfshirëse e cila gërsheton të menduarit zgjedhor me sistemin partiak dhe ndarjet të cilat ekzistojnë në shoqëri (Horowitz 2003: 23). Për më tepër, ai shton se vendosja për një sistem zgjedhor, përfshin përbrenda vetës këmbimin e "një vlere për një tjetër, duke shkaktuar, qoftë edhe atëherë, pasoja të paparashikueshme" (Horowitz 2003).

Sfida e sistemit zgjedhor qëndron në ekuilibrimin e asaj se:

- Çfarë është e drejtë?
- Çfarë mund të funksionojë?
- Çfarë nuk kushton shumë?

**Vlerat të cilat do të duhej të mbrohen dhe nxiten përmes sistemit zgjedhor:**

(a) Një sistem zgjedhor me të cilin mund të identifikohen qytetarët ("pronësia" e qytetarëve ndaj procesit zgjedhor që merr për bazë kulturën vendore);
(b) Nxitja e integrimit, në vend të ndarjes së bashkësive;
(c) Identifikimi me përfaqësues dhe llogaridhënia e të zgjedhurve;
(d) Institucione të përgjegjshme dhe llogaridhënëse;
(e) Vota përtej kampeve etnike;
(f) Një sistem zgjedhor që kuptohet lehtë (Roth);
(g) Një sistem relativisht i lirë;
(h) Institucione demokratike për të gjithë në vend të kompromiseve etnike jetëshkurtra.

**Katër faktorët relevantë të cilët mund të jenë objekt diskutimi:**

- Formula zgjedhore (format e ndryshme të përfaqësimit proporcional);
- Përmasat e njësive zgjedhore (numri i përfaqësuesve që zgjedhen për njësi zgjedhore);
- Pragu minimal për zgjedhje (përkrahja minimale të cilën duhet ta arrijë partia për të qenë e përfaqësuar);
- Madhësia e trupit përfaqësues.

## 9. ÇFARË DUHET TË DEBATOJNË LIDERËT POLITIKË DHE OPINIONI PUBLIK?

Më së miri është që të fillohet me një listë të gjërave të cilat synohet të arrihen, shmangen dhe duke krijuar vizionin për atë se ku synon të arrijë Kosova. Një numër i çështjeve të mbarështruara në bazë të vlerave do të duhej të diskutohet nga publiku kosovar, si një parakusht për diskutimin e sistemit zgjedhor. Në vend së të hudhemi në diskutime për listat e hapura apo të mbyllura, është e nevojshme që kosovarët të qartësojnë vizionin dhe të diskutojnë mes vete tiparet e sistemit politik që i konsiderojnë të vlefshme për të punuar drejt jetësimit të tyre apo për të evituar disa të tjera. Disa nga çështjet për këto debate janë mbarështruar si vijon:

(a) ***Fuqia e qeverisë*** - Qeveria e koalicionit: qeveri e brishtë me opozitë e dobët apo qeveri e fuqishme me opozitë të zëshme? Sa e dobishme është nevoja dhe mundësia e krijimit të aleancave në një demokraci të papjekur? Çfarë ka qenë roli i opozitës në Kosovë? Pse partitë e pakicave kanë tendenca të dalin nga seancat në Kuvend?

(b) ***Llogaridhënia*** - individuale, partiake. A dëshirojmë që njerëzit të kërkojnë llogari nga individët apo nga partitë? Çfarë është treguar e suksesshme deri më tani? Për kënd votojnë qytetarët: për partitë, individët apo për të dyjat?

(c) ***Përfaqësimi gjeografik*** (një numër i komunave kanë përfunduar pa asnjë përfaqësues në Kuvend). A dëshirojmë që elektorati të ndjehet se interesat e caktuara gjeografike janë të përfaqësuara në Kuvend? A mund një deputet nga radhët e AAK-së prej Gjilanit t'i përfaqësojë më mirë interesat e votuesve të AAK-së nga Gjakova, sesa që këtë do ta bënte një deputet prej Gjakovës nga radhët e LDK-së? A duhet të jetë Kosova një njësi e vetme zgjedhore apo duhet krijuar disa njësi zgjedhore për të siguruar përfaqësim gjeografik? Në rast se duhet krijuar disa njësi, atëherë a është e arsyeshme që t'i rrekemi dizajnimit të njësive zgjedhore krejtësisht të reja apo është më mirë tu shmangemi politizimeve të tepërta të një procesi potencialisht të rrezikshëm dhe të mbajmë komunat si kufi të njësive zgjedhore?

(d) ***Si të arrihet zhvillimi i fushatave për çështje konkrete?*** Votimi ideologjik, pragmatik përballë votimit etnik? Për shkak të trashëgimisë së luftës, njerëzit vazhdojnë të votojnë përgjatë vijave etnike apo përgjatë vijave të luftës për çlirim. Edhe përkatësia etnike është çështje konkrete, por kjo ndodh vetëm për shkak shteti jugosllav kishte filluar luftë sipas kriterit etnik, pra duke sulmuar shqiptarët për shkak të përkatësisë së tyre etnike; ngjashëm, një numër shqiptarësh janë hakmarrë ndaj serbëve. Shoqëria duhet të mëtojë që të riorientojë interesat e qytetarëve drejt brengave të tyre specifike. Një gjë e tillë nuk bëhet për të zbehur rëndësinë e etnisë, meqë edhe kjo mund të jete një nevojë specifike, megjithëse kryesisht paraqiten në kohë krizash. Në mënyë që procesi zgjedhor të ketë ndikim pajtues, ai duhet t'u qaset çështjeve etnike në atë mënyrë që të mos shkatërrojë marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicës. Në afat të gjatë, çështjet etnike nuk do të duhej të jenë pjesë e zhvillimit të fushatave konkrete zgjedhore. Një ndarje e vetme (ku përputhen ndarjet gjuhësore, etnike, fetare që krijojnë dy grupe homogjene) është burim i shpeshtë i konfliktit të armatosur. Lijphart argumenton se duhet të krijohen vija të reja ndarëse që të zbusin theksin e ndarjes kryesore dhe rrjedhimisht të zvogëlojnë gjasat për luftë. Megjithatë, me synim të nxitjes së politikanëve drejt aktivitetit paqesor, efektiv dhe efikas, partitë duhet të fillojnë të zhvillojnë profilizime ideologjike dhe t'u përgjigjen kërkesave të grupeve të caktuara të votuesve. Si mund të arrihet kjo më së miri? Opozitë e fuqishme? Përgjegjësi më të mëdha? Vija të qarta të përgjegjshmërisë?

(e) ***Përfaqësimi i pakicave*** - proporcionaliteti, përfaqësimi i fryrë (qoftë edhe në dëm të marrëdhënieve ndëretnike?) apo përparësi të veçanta në nivel më të ulët, mekanizma kushtetuese speciale për mbrojtjen e interesave të pakicave (kultura, gjuha, arsimi)? A e forcojnë pakicën realisht vendet e rezervuara për ta? Çfarë nëse vazhdojnë konfliktet? Në rast se ekziston perceptimi se një

grup entik konkret është kërcënim për pushtet, a do të mobilizojë kjo shumicën në tejkalim të dallimeve në këtë kontekst. Në disa shtete, vendet e rezervuara vetëm konsiderohen si të përshtatshme për grupe të vogla që nuk paraqesin rrezik për shumicën. Meqë vendet e rezervuara iritojnë shumicën për shkak të cenimit të rregullës "një person, një vote", mjete të ndryshme juridike mund të jenë më të përshtatshme sesa përfaqësimi i fryrë. Vendet e rezervuara duhet t'ua mundësojnë pakicave të përfaqësohen, por jo të ndryshojnë spektrin politik dhe balansimin politik në marrëdhëniet përbrenda shumicës. Rrjedhimisht, proporcionaliteti adekuat mund të jetë më i përshtatshëm në rast se është i kombinuar me mekanizma të tjerë sesa në formë të cenimit të vrazhdë të rregullës "një person – një votë". Ndjenja e privilegjeve të vazhdueshme tej-demokratike mund të ruajë mentalitetin e "luftës së ftohtë"dhe të pengojë që këndvështrimet jo-etnike dhe çështjet praktike të mbizotërojnë gjatë fushatave zgjedhore. A ka gjasa për vota që kalojnë kufijtë ndërmjet etnive? Florian Bieber pohon se "fakti që partitë politike duhet të identifikohen si parti të pakicave para zgjedhjeve e bën pothuajse të pamundur krijimin e partive ndër-etnike".

(f) ***Formësimi dhe kohezioni përbrenda partive politike.*** A dëshirojnë kosovarët parti të fuqishme, liderë të fortë dhe bazë të dobët apo liderë të dobët por me një bazë elektorale të fortë?

(g) ***Trendet e pjesëmarrjes në zgjedhje*** - besimi në sistem? Besimi në mundësinë për të bërë ndryshime? Ndoshta pika e referimit për vitin 2000 është tejet e lartë për shkak të çlirimit dhe të euforisë së atëhershme dhe se një dalje masive e tillë nuk mund të pritet më. Cila është përqindja e mjaftueshme e cila do të legjitimonte zgjedhjet? A duhet që votimi të jetë i detyrueshëm? 50%? Pa kusht?

(h) ***Të zhvendosurit dhe diaspora*** - në njësitë zgjedhore fillestare apo duhet krijuar njësi të reja? E drejta në votë: kriteret e përdorura nga UNMIK-u për regjistrim civil mundësojnë të drejtën e zgjedhjes çdo refugjati sërb nga Kroacia që ka vendosur për t'u bërë banor i Kosovës. Kushte për së paku një prind nga Kosova mund të bartë të drejtën për votë në Kosovë më shumë se dy milion shtetasve turq me origjinë kosovare në rast se ata vendosin të votojnë në Kosovë.

(i) ***Përmasat mesatare të njësive zgjedhore*** - Ndarja e numrit të përgjithshëm të vendeve në Kuvend me numrin e njësive zgjedhore. Cili është numri ideal i qytetarëve të cilët do të duhej përfaqësuar në Kuvend përmes një deputeti? Merr parasysh edhe bashkësitë e vogla! Ndër kuvendet komunale, një deputet në Prishtinë përfaqëson 2.604 qytetarë (mesatare e zgjedhjeve të vitit 2000 dhe 2003), derisa në Artanë një deputet i përfaqëson 108 qytetarë. Përmasat e njësive zgjedhore gjithashtu ndikojnë proporcionalitetin e mund-

shëm të rezultateve. Lijphart thotë se madhësia e njësisë zgjedhore prej dhjetë është e mjaftueshme. Autorë të tjerë thonë se madhësia e njësive zgjedhore prej pesë po ashtu mund të sjellë rezultate po aq proporcionale." (Ilirjani).

(j) ***Pragu minimal*** për përfaqësim (minimumi i përqindjes së votave të cilat një parti mund të fitojë për të marrë një vend të deputetit) (Lijphart 1994). Pragu i përjashtimit: maksimumi i përqindjes së votave të cilat, në kushte ideale mund të jenë të pamjaftueshme që partia të fitojë një vend deputeti. Pragu i ulët dhe i lartë: fitimi i pragut të ulët = e mundshme për të fituar një vend; në rast se e kalon pragun e lartë = garanton për të fituar një vend.

Çdo sistem zgjedhor ngërthen në vete favorizime të ndryshme. Sipas Horowitz-it, "Fakti që çdo sistem zgjedhor përmbanë në vete një numër të animeve të ndryshme ndaj sistemeve të ndryshme zgjedhore, nënkupton se ata që zgjedhin ndërmjet sistemeve të ndryshme zgjedhore, në thelb vendosin për një tërësi animesh përballë animeve të tjera. Ndërsa, të parapëlqesh njërin anim përballë tjetrit paraqet një qëndrim politik" (Horowitz 3). Qëllimi nuk qëndron në eliminimin e të gjitha animeve, por në zgjedhjen ee atyre më pozitive të cilat do të sjellin vlerat e identifikuara si të dëshirueshme. Rrjedhimisht, animet duhet të janë të planifikuara dhe të bëra me vetëdije përmes konsensusit.

## 10. MBROJTJA E PAKICAVE

Një ndër çështjet kryesore të këtij debati është mbrojtja e pakicave. Një sistem zgjedhor që nuk është i përqafuar nga të gjitha forcat politike nuk do të gëzonte konsensusin e nevojshëm. Një zyrtar ndërkombëtar pohon se "zgjedhjet e vitit 2004 pa përfshirje serioze të serbëve nuk do të pranoheshin nga bashkësia ndërkombëtare" (Caldwell). Ky është një fakt për të cilin liderët kosovarë janë të vetëdijshëm. Edhe përkundër një kritike të gjerë ndaj vendeve të rezervuara, këshilltari i Kryetarit të Kuvendit, Ramush Tahiri pohon se "diskriminimi pozitiv nuk duhet të jetë shqetësim për konsensusin ndërpartiak, meqë ky diskriminim asnjëherë nuk mund të kalojë 20% dhe ne nuk jemi të interesuar që të humbim interesimin e serbëve për pjesëmarrje në Kuvend." Zyrtarët ndërkombëtarë shumë herë kanë përsëritur se akomodimi ndaj serbëve është formula më e mirë për shmangien e ndarjes së veriut të Kosovës.

Është me rëndësi për të vënë re se Kosova nuk paraqet një shoqëri me polarizime të mëdha, por se ajo përballet më një ndarje të thellë ndërmjet dy bashkësive që përshkon vijat etnike, gjuhësore dhe fetare. Siç e përmend Horowitz, "në rast se disa grupe sociale janë organizuar në parti politike, ku secila mund të fitojnë një pjesë të vogël nga numri i përgjithshëm i votave, gjasat janë që dallimet politike vetëm sa do të zgjerohen në vend se të tkurren" (2003: 15). Si rezultat i kësaj, vendet e rezervuara, të cilat i shtyejnë partitë për t'u identifikuar sipas kriterit etnik e bartin këtë ndarje të thellë edhe në

Kuvend. Kjo mund të jetë e mirë vetëm për aq sa Kuvendi shërben si një pasqyrim real i gjendjes ekzistuese. Megjithatë, kështu nuk është shfrytëzuar potenciali pajtues i sistemit zgjedhor. "Duke qenë se në shoqëritë me ndarje të thellë shumica e zgjedhjeve politike janë të kufizuara brenda grupit më shumë se ndërmjet grupeve, ky sistem ka gjasa shumë të ulëta për të sjellë përmirësime rrënjësore të marrëdhënieve ndëretnike përderisa shumica dërmuese e anëtarëve të grupit votojnë për partitë njëetnike" (Bieber 2003: 8). Kjo do të thotë se sistemi zgjedhor nuk e nxitë moderimin gjatë fushatave zgjedhore dhe joshja e votave nga një konstituencë e vetme mbetet një ideal i largët. Sipas Sartorit, cituar nga Horowitz, "qeveritë mund të krijohen vetëm me vështirësi, përbërja e tyre mund të jetë e paparashikueshme dhe qëndrueshmëria e tyre e dyshimtë. Kjo gjendje, e emërtuar nga Sartori si "pluralizëm i polarizuar" paraqet një gjendje të nxitur nga sistemi proporcional dhe favorizuese e mungesës së mobilizimit. Partitë përkujdesen vetëm për përkrahësit e tyre dhe është e vështirë arritja e kompromiseve" (15-16).

## *Vendet e rezervuara*

Vendet e rezervuara janë vënë në zbatim si një metodë e përkohshme për të bërë pakicat të ndjehen më mirë të përfaqësuara, veçanërisht në rast se nuk marrin pjesë në zgjedhje në numër të madh. Megjithatë, siç është thënë më lart, kjo nuk ka sjellë deri tek garanca përmbajtësore për ta. Pakicat nuk kanë nevojë për sistem i cili u jep atyre pushtet simbolik , por për një ndikim të vërtetë, gjë që me gjasë do të shndërronte votat e tyre në një "vlerë për kandidatët e shumicës, e jo vetëm në triska zgjedhore" (Horowitz 2003). Në rast se një ndër arsyet kryesore për zbatimin e vendeve të rezervuara ka qenë frika nga pjesëmarrja e ulët e serbëve në zgjedhje, në zgjedhjet e fundit, serbët kanë marrë pjesë pothuajse në përqindje të njejtë sikurse edhe shqiptarët, ndonëse kështu ka qenë rast vetëm në ato komuna në të cilat sërbët përbëjnë shumicën. Në gjithë botën perëndimore, proporcionaliteti i skajshëm konsiderohet si qëllim optimal për pakicat. Meqë pakicat në Kosovë janë relativisht të pakta në numër, asnjë rritje në numër nuk do të mund të mbronte interesat vitale të këtyre bashkësive. Qëndrimi politikisht më korrekt do të ishte mbrojtja e vendeve të rezervuara, por ky punim pohon se masa në fjalë ka pasur kundërefekte edhe më të mëdha sesa epërsitë e saj. Duke dalluar vendet e rezervuara nga mekanizmat tjerë të mbrojtjes së pakicave, Bieber konkludon se "në përgjithësi, vendet e rezervuara janë mjeti më i papërshtatshëm për përfshierjen e grupeve në organet e zgjedhura. Jo vetëm që kjo mund të sjellë deri tek armiqësimi i shumicës, por edhe krijon një kontekst të veçantë për pjesëmarrjen e pakicave në jetën politike të vendit. (2003: 10).

Po ashtu, janë edhe trendet demografike ato të cilat kanë efekt negativ ndaj pakicave. Për çdo zgjedhje, rreth 50.000 – 60.000 persona, kryesisht shqiptarë që votojnë për herë të parë, do të reduktojnë fuqinë relative të përfaqësimit të fryrë gjatë viteve që pasojnë.

## *Minimizimi i votave të humbura*

Në rast se vendet e rezervuara paraqesin një koncept që duhet braktisur, duhet që së paku të bëhen përpjekje për të minimizuar numrin e votave të popullatës gjeografikisht të shpërndarë, siç është rasti me disa nga bashkësitë pakicë. Për të siguruar këtë ekzistojnë dy mënyra: (a) sigurimi i një përfaqësimi proporcional përmes vendeve shtesë nga listat e mbyllura (Eng: top-up) (një numër i vendeve do të mund të jepej përmes listave të mbyllura dhe pjesa tjetër në bazë të njësive zgjedhore) apo (b) krijimi i njësive zgjedhore jo-territoriale, ku pakicat territorialisht të shpërndara do të përbënin një njësi zgjedhore në vete (shih më poshtë përshkrimin e opcioneve të prezentuara më poshtë). Për shembull, në rast se serbët poshtë lumit Ibër përbëjnë 3,3% të popullsisë, ata do të mund të formonin një njësi zgjedhore prej së cilës do të zgjedheshin tre deputetë. Në të kundërtën votat e tyre do të "humbeshin" për shkak të numrin të tyre inferior përballë shqiptarëve në pjesët ku dominojnë këta të fundit. Këto në fakt nuk do të humbeshin, por do të kompenzoheshin përmes listave të mbyllura; votat e tyre do të shkonin tek partitë nga veriu që nuk e përfaqësojnë domosdo interesin e bashkësisë së shpërndarë sërbe nëpër Kosovë. Pasi që sërbët në jug të Ibrit mund të kenë interesa të tjerë, ata do të duhej të kenë mundësinë të zgjedhin përfaqësuesit e tyra pa marrë parasysh vullnetin e atyre në veri. Rjedhimisht, njësitë e shpërndara zgjedhore në një mënyrë do të forconin serbët në jug të lumit Ibër e në barrë të atyre në veri. Siç pohon ICG, "ata që janë të izoluar në enklavat brenda Kosovës ndjehen më të brishtë përballë dhunës dhe formave të tjera të presionit nga shqiptarët, dhe përgjithësisht kanë motive më të forta për të gjetur një *modus vivendi* me shqiptarët në Kosovë" (ICG 2001: 16). Varësisht nga numri i shqiptarëve në veri të lumit Ibër dhe/apo numrit të diasporës, do të mund të kishim më shumë se një njësi zgjedhore të këtillë. Edhe me këtë rast, votat e anëtarit të tretë apo të katërt, përndryshe të humbura, do t'u shpërndaheshin partive dhe do të llogariteshin në favor të proporcionalitetit të përgjithshëm. Këto njësi do të kishin edhe efektin pozitiv të pasurimit të pluralizmit edhe në skenën politike të pakicave pa u shkaktuar humbje në vende përfaqësuese. Siç pohon Horowitz këto "zgjidhje joterritoriale për pakicat e shpërndara i nxjerrin ato nga grumbulli i votave të cilat përndryshe politikanët në shumicë do të dëshironin t'i joshin në raste kur gara zgjedhore është e ngushtë." Megjithatë, siç është pohuar më lart, ndarjet e thella të cilat ndajnë shqiptarët dhe serbët nuk lënë shpresë që kjo të ndodhë. Përderisa, idealisht sistemi do të duhej të parashohë nxitës që partitë e shumicës të joshin votat e pakicës, Kosova, për shkak të ndarjeve të thella, sot duhet të hulumtojë modelet e akomodimit në vend se ato të bashkëpunimit. Me uljen e tensioneve, kjo megjithatë mbetet opcion për të ardhmën.

## *Mbajtja e vendeve të rezervuara për pakicat josërbe*

Vendet e rezervuara ende do të mund të ishin të dobishme për pakicat të cilat nuk rrezikojnë primatin politik të shumicës dhe të cilat përndryshe nuk do të përfaqësoheshin në Kuvend. Prandaj, duhet mbajtur një numër i vendeve të rezervuara për pakicat e vogla, duke vijuar kështu shembujt e Kroacisë, Sllovenisë, Malit të Zi dhe

Rumanisë, sipas Bieber-it.

### *Garancat kushtetuese dhe mjetet tjera që mund të jenë në dispozicion për pakicat*

Meqë sistemi zgjedhor nuk mjafton për mbrojtjen e interesave jetësore të pakicave në kohë krizash apo ndaj diskriminimit të përditshëm, kosovarët duhet të debatojnë për atë se çfarë masash tjera kushtetuese, gjyqësore apo legjislative mund të vendosë çështjet specifike që u përkasin vetëm pakicave nën kontrollin e tyre. Analizimi i kësaj problematike del jashtë suazave të këtij punimi, por mund të thuhet se një ligj për mosdiskriminimin do të mund të ishte shumë më i dobishëm sesa rritja e numrit të përfaqësuesve serbë në Kuvend që iriton shumicën dhe tërthorazi e keqëson ambientin ndëretnik.

(a) Garanca kushtetuese;
(b) E drejta e vetos në çështje të interesit të tyre në nivel komunal (kulturë, fe, gjuhë, arsim);
(c) Proporcionalitet i skajshëm;
(d) Eliminimi i votave të "humbura";
(e) Komitete të Komuniteteve;
(f) Një prag i ulët për inicimin e mocionit kundër ligjeve të cilat cenojnë të drejtat e bashkësive (pas së cilës do të nevojitej konsensusi i anëtarëve të Kryesisë së Parlamentit, apo panelit, ku në të dyja prej tyre pakicat kanë një përfaqësim të konsiderueshëm);
(g) Përgjegjësitë e PSSP-së.

## 11. SFIDAT PËR NJË PËRFAQËSIM GJEOGRAFIK DHE NJËSITË ZGJEDHORE SHUMËANËTARËSHE

Përkatësia partiake dhe etnike nuk janë përcaktuesit vendimtarë të vetëm të interesave të qytetarëve. Përfaqësimi gjeografik shpesh paraqet një segment tjetër me rëndësi, veçanërisht në shoqëritë me lidhje të ngushta familjare që merren me bujqësi sikur që është rasti në Kosovë. Prandaj, cilësia e përfaqësimit gjeografik dhe e lidhjeve të kësaj natyre me elektoratin paraqet një sfidë të cilën duhet ta tejkalojë sistemi zgjedhor i Kosovës.

Kur misioni i OSBE-së në Kosovë anoi kah një njësi zgjedhore e vetme në vitin 2001, kjo ishte bërë për shkaqe të thjeshtësisë. Megjithatë, në atë kohë që "tri partitë politike shqiptare parapëlqenin sistemin e njësive zgjedhore shumëanëtarëshe, me deputetët individualë si përfaqësues të trupit zgjedhor të një vendi të caktuar (ICG 2001: 5).

Përcaktimi i njësive zgjedhore është proces i ndërlikuar, dhe hartimi i tyre duhet të përcjellë këto kritere: shpërndarje të barabartë të votuesve, njësi kompakte zgjedhore, të

mbulojë bashkësi të natyrshme dhe territor të pandërprerë. Para zgjedhjeve për Kuvend në vitin 2001, u refuzua krijimi i tyre për shkak se nuk kishte "të dhëna demografike mbi popullatën" (ICG 2001, 5). Misioni i OSBE-së gjithashtu tërhoqi vërejtjen kundër krijimit të njësive zgjedhore njëanëtarëshe: "Pa pasur të dhëna më të plota demografike, krijimi i njësive zgjedhore në Kosovë mund të shpie drejt shpërputhjeve serioze të peshës së votës. Disa grupe votuesish do të përfitojnë në llogari të tjerëve" (2001). Sidoqoftë, krijimi i njësive me popullatë të barabartë është tejet i vështirë dhe politikisht i ndjeshëm. Mirëpo, nuk është dhënë asnjë arsyetim pse një sistem i bazuar në 30 komunat ishte refuzuar në vitin 2001. Pasi që sistemi mazhoritar, i asocuar me njësitë zgjedhore njëanëtarëshe, nuk konsiderohet si i përshtatshëm për Kosovë, nuk ka nevojë të diskutohet në këtë punim.

Prandaj, përfaqësimi gjeografik do të mund të zgjidhej përmes njësive zgjedhore me disa deputetë të zgjedhur në to, të cilat njësi përputhen me komunat dhe secila komunë/njësi zgjedhore gëzon një numër proporcional të vendeve, varësisht nga numri i banorëve të moshës votuese. Kjo parandalon manipulimin territorial gjatë procesit të ndërlikuar e të kushtueshëm të dizajnimit të njësive zgjedhore. Ky sistem është përdorur edhe në Bosnjë, ku njësitë zgjedhore shumëanëtarëshe përfshijnë nga disa komuna dhe nëse kjo e ul çmimin mund të paraqitet si opcion për disa komuna më të vogla.

Në rast vendosjeje për krijimin e njësive zgjedhore me një anëtar, këto njësi do të duhej të respektonin faktorët demografikë, gjeografikë, kulturorë dhe etnikë. Është gjithashtu e rëndësishme që të arrihet pajtimi për ate se kush mund të vendosë për caktimin e kufijve të njësive zgjedhore, me qëllim të shmangjes së manipulimit të këtyre kufijve me qëllime politike. Është shumë me rëndësi të diskutohet se cilat pushtete përpiqen ti shtojnë njësitë zgjedhore dhe se a krijohen në baza homogjene apo heterogjene. Në rast se janë homogjene, a fuqizojnë dhe krijojnë shumicë-pakicë në to? Kosova nuk është një vend i madh me shumë interesa të shpërndara gjeografikisht. Ndonëse kjo është e dëshirueshme, nuk shkohet deri në atë masë sa të jetë i dëshirueshëm copëzimi i mëtejmë duke krijuar njësi zgjedhore një-anëtarëshe.

## 12. SFIDA E LISTAVE TË HAPURA DHE PËRFAQËSIMI GJINOR

Konsiderohet se listat e mbyllura sigurojnë një përfaqësim më të mirë të femrave. Kosova tani është në vendin e 12-të sipas përfaqësimit të femrave në Kuvend, ndonëse kjo më shumë ka qenë rezultat e rregullës për një të tretën e kandidateve femra, sesa për shkak të vetë efekteve të listave të mbyllura. Rregulla të ngjashme mund të zbatohen po ashtu edhe te listat e hapura, megjithëse me çmim më të lartë politik. Sidoqoftë, nëse vetë përfaqësimi i femrave është një nga përparësitë e listave të mbyllura, kjo ndodhë në dëm të opinionit publik. Sipas një ankete të zhilluar në fillim të vitit 2001, 91,6% të zyrtarëve të intervistuar shpreheshin se votuesit parapëlqejnë të votojnë për individët e jo për partitë (Thiel/IFES 10). Me atë rast IFES kishte rekomanduar që t'i "kushto-

het vëmendje serioze zbatimit të listave të hapura, sikurse që është bërë ne vitin 2000" (IFES/Thiel 32). Listat e hapura janë çelësi për të siguruar që zyrtarët t'u japin llogari atyre prej të cilëve janë zgjedhur. Prandaj, listat e hapura shërbejnë për të kompenzuar mangësitë kryesore të sistemit proporcional me lista të mbyllura, gjegjësisht mungesën e llogaridhënies së drejtpërdrejt. Meqë shumica e partive në Kosovë edhe ashtu nuk përfshijnë pjesëtarë të pakicave në listat e tyre, është e paqëndrueshme kritika se listat e hapura dëmtojnë kandidatët e mundshëm nga radhët e pakicave.

Mangësitë e njësive një anëtarëshe janë:

(a) Partitë e pakicave fitojnë pak ose aspak përfaqësim;
(b) Partitë e mëdha fitojnë vende shtesë mbi pjesëmarrjen e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë;
(c) Qeveritë me 100% të pushtetit ekzekutiv krijohen edhe me më pak se 50% të votave;

Qeveritë e bazuara në shumicë të thjeshtë apo në votë popullore shpërblehen me super-shumicë në përfaqësim (Reynolds 1995).

Përderisa njësitë zgjedhore një-anëtarëshe ofrojnë cilësi më të mirë të përfaqësimit, sistemi proporcional mundëson përfaqësim proporcional. Për të zgjidhur problemin e llogaridhënies vertikale të sistemeve proporcionale, Reynolds propozon një verzion të përshtatur të sistemit proporcional me njësi zgjedhore më numër të vogël anëtarësh, të dizajnuara në përputhje me kufijtë gjeografikë dhe shoqërore, dhe lista të hapura. Një sistem i tillë do të përmirësonte disa nga problemet e sistemit proporcional, do të mundësont nxitje më të madhe për partitë që të jenë të hapura dhe përfshirëse nga aspekti etnik, duke ruajtur njëkohësisht përparësitë e përgjithshme të cilat sistemi proporcional i ofron në shoqëritë heterogjene.

Listat e hapura e rrisin llogaridhënien individuale, megjithëse është më vështirë të sigurohet niveli i tanishëm i zgjedhjes së grave dhe pakicave. Megjithatë, në vitit 2004 do të jenë bërë pesë vite që nga përfundimi i luftës, dhe rregulla e përfaqësimit "një e treta" për gratë tanimë do të ketë forcuar rolin dhe numrin e tyre. Rrjedhimisht, do të ketë gra të cilat janë të gjendje të kandidohen dhe fitojnë në baza meritore. Efektet praktike të përfaqësimit gjinor në Kuvend kanë filluar të vërehen edhe ndër zyrtarë të lartë. Këshilltari i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës pohonte se femrat janë "më pak ekstreme dhe se ato kanë ulur tensionet"(Tahiri 2002). Listat e hapura mund të shtojnë aktivitetet e femrave në fitim të votave dhe drejt forcimit të kredibilitetit të tyre politik e jo vetëm sa për përfaqësim simbolik.

Por, ka gjithashtu edhe mekanizma të tjerë për të siguruar përfaqësimin e grave. Një numër i vendeve që mund të shpërndahet në vendet shtesë nga listat e mbyllura, ku do të mund të zbatohej një kriter edhe më i lartë. Psh. nëse rregulla për 1/3 e kandidatëve gra është zbatuar në listat e përgjithshme deri më tani, rregulla për një të dytën do të mund të zbatohej vetëm për vendet shtesë sipas listave të mbyllura në nivelin mbarë-kosovarë. Sidoqoftë, një kombinim i pjekurisë demokratike dhe i një rregulle më të butë për përfaqësimin e grave do të ishte në gjendje të sjellë deri tek një përfaqësim i

konsiderueshëm i grave në organet ligjvënëse. Në vend të garantimit të pakontestuar dhe të padiskutueshëm të vendeve të caktuara për gra të cilat do të kenë një ndikim dhe popullaritet të kufizuar, ato që do të zgjedheshin sipas mënyrës në fjalë do të kishin vendet sipas një baze shumë më meritore me numër të afërt sikurse që kemi pasur me deri më tani përmes listave të mbyllura.

Mund të argumentohet se rregulli 1/3 mund të sforcohet edhe në lista të hapura, mirëpo, kjo është vështirë të arsyetohet sepse femrat me shumë më pak vota mund të lëvizin më lartë në listë përpara mashkujve me më shumë vota, çfarë do të krijonte klimë konfliktuoze politike në degët e partive.

Çështje të tjera përfshijnë: planin kohor, listat e votuesve (të dhënat problematike dhe jo të klasifikuara nga regjistri civil), kornizën ligjore (kompetencë e rezervuar apo jo).

## 13. ÇFARË SISTEMI KOSOVA SYNON NË PARIM?

Para se ky punim të filtrojë opcionet e mundshme në një parim të rëndësishëm, është me rëndësi që të vehet re ndarja e përgjithshme e sistemeve zgjedhore të disponueshme për vendimmarrësit në shoqëritë e ndara.

Në vija të trasha ekzistojnë tri sisteme zgjedhore kryesore: [4]

a) Sistemi proporcional (i skajshëm apo jo, pa vende të rezervuara)
b) I përzier (me apo pa vende të rezervuara)
c) Strikt mazhoritar (me apo pa vende të rezervuara)

| **Pasqyrimi i votave** | **Territorializimi** | **Tjera** |
|---|---|---|
| Sistemet mazhorative-plurale | Njësitë zgjedhore njëanëtarëshe | Pragu |
| Sistemet gjysëm-proporcionale | Njësitë zgjedhore shumëanëtarëshe | Vendet e rezervuara |
| Sistemet proporcionale | Një njësi zgjedhore për tërë vendin | Ndalimi i partive etnike |

Bieber (2003: 2) prezentoi "qasjet ndaj sistemeve zgjedhore në shoqëri të përziera": Duke e konsideruar pikënisjen e tanishme, pra proporcionalitet strikt me vende të rezervuara, ky punim nuk përpiqet që të ndryshojë spektrin politik ndërmjet entiteteve politike, por përpiqet të ndryshojë kulturën politike në bazë të së cilës entitetet politike garojnë njëra me tjetrën, dhe si rezultat nuk propozon ndryshim rrënjësor, por inkremental. Për shembull, ky punim i merr disa gjëra si të dhëna, si madhësinë e Kuvendit (120) dhe nuk bën përpjekje për të analizuar se a duhet të ndryshohet kjo apo jo. Siç thotë Horowitz, "askush nuk duhet të presë ndryshime drastike në trendet e sjelljes pasi që të jenë ndryshuar stimulimet zgjedhore. Mirëpo, nganjëherë, edhe ndryshimet inkrementale mund të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme (3). Për këtë arsye, modeli i cili avokohet me këtë rast ka gjasa të prodhojë të njejtat rezultate si edhe në të kaluarën, por

përmes një dinamike tjetër të ndër-veprimit të qytetarëve dhe institucioneve publike. (4). Për shkak të gjatësisë së këtij punimi, nuk janë elaboruar përparësitë dhe mangësitë e gjitha sistemeve të tjera. Për më shumë informata lidhur me këtë, rekomandohet konsultimi i Doracakut të IDEA-s për Dizajnimin e Sistemeve Zgjedhore.

Ngjashëm me sistemin gjerman, sistemi i sygjeruar më poshtë përpiqet të maksimalizojë më shumë se një qëllim. "Sistemi gjerman, për shembull, është sistem i bazuar në njësi zgjedhore, por me një shtesë të proporcionalitetit, ashtu që ligjvënësit të kenë arsye t'u përgjigjen njësive të tyre zgjedhore, ndërsa partitë marrin një numër të përgjithshëm të ulëseve që është pak a shumë në përpjestim me numrin e votave të fituara në mbarë vendin. Ekziston një trend që sa vie duke u forcuar drejt sistemeve të përziera që synojnë arritjen e më shumë qëllimeve, siç kanë përshtatur sistemet e tyre të mëhershme Zelanda e Re, Italia dhe Japonia" (Horowitz 2003: 12-13).

Sikundër edhe në vendet tjera në Evropën Juglindore, kosovarët parapëlqejnë përfaqësimin proporcional. Vetëm 13% të të intervistuarve mendonin se entitetit politik që fiton zgjedhjet duhet t'i takojnë të gjitha vendet përfaqësuese në komunë, përderisa 46% nuk pajtoheshin me këtë, ndërsa 20% nuk pajtoheshin fare me këtë. (IFES/Thiel 36). Në të njëjtin kontekst, 90,8% mendonin se entitetet politike duhet të marrin vende përfaqësuese në përpjestim me numrin e votave të fituara (Thiel/IFES 10).

Përfundimisht, Kosova ka nevojë për një kombinim të përfaqësimit të përgjithshëm proporcional, përderisa mëton të vendosë lidhje më të mirë me trupin zgjedhor përmes njësive të caktuara zgjedhore. Meqë njësitë zgjedhore njëanëtarëshe konsiderohen të dëmshme, dizajnuesit e sistemit zgjedhor në Kosovë, duhet të kufizojnë hulumtimin brenda suazave të sistemit proporcional, listave të hapura dhe njësive zgjedhore shumëanëtarëshe.

## 14. VARIACIONET E REKOMANDUARA

Ndonëse ky punim sugjeron një opcion të gjerë, ka variacione të shumta të cilat mund të diskutohen në vendosje të konsensusit ndërmjet të gjitha palëve me interes në këtë proces.

Madhësia e trupit përfaqësues: 120 (më shume vende/më shumë proporcionalitet).

| | |
|---|---|
| Zona dy rrathëshe: | 70-80 vende të shpërndara nga listat e hapura në bazë komunale dhe 30-40 vende *kompenzuese* nga listat e mbyllura në nivel kombëtar; mundësia e votimit për parti apo për kandidatin individual (varësisht nga numri i vendeve të rezervuara – asnjë vend të rezervuar: 80/40; 10: 75/35; 20: 70/30). |
| Proporcionaliteti i përgjithshëm: | Ky sistem rezulton me proporcionalitet të ska- |

jshëm. Vendet shtesë (30-40 nga listat e mbyllura) janë dizajnuar për të kompenzuar epërsinë që shumica e fiton nga vendet e shpërndara sipas listave të hapura komunale dhe siguron proporcionalitet final.

Llogaridhënia: Lista të hapura për të siguruar raport ndëmjet votuesit dhe deputetit. Duhet të analizohet mundësia e krijimit të një kuote minimale për komunat e vogla të cilat përndryshe nuk do të ishin të përfaqësuara (ose kuotë prej një deputeti për secilën komunë ose bashkimi i komunave të vogla fqinje në një zonë zgjedhore të vetme).

Njësitë zgjedhore: Njësi zgjedhore shumëanëtarëshe në përputhje me komunat dhe me shndërrimin e numrit të votuesve në numër proporcional të vendeve në Kuvend. Mundësia e bashkimit të disa komunave.

Variacion: Njësi zgjedhore jo-territoriale për pakicat e shpërndara territorialisht dhe për diasporën: (i) serbët/shqiptarët nga komunat ku janë pakicë, (ii) turqit, (iii) bashkësitë rome, ashkali dhe egjiptase, (iv) boshnjakët, (v) diaspora. Krijimi i njësive për pjesë të popullatës nuk është mekanizëm i testuar mirë dhe duhet të analizohet e planifikohet mirë. Gjithashtu njësitë e veçanta zgjedhore për diasporë nuk janë treguar të suksesshme në vendet tjera si për shembull në Kroaci, thotë Bieber.

Rregulla për gjinitë: Dy opcione:

(a) Një rregull për përfaqësim të gjinive (1/3-1/2) në vendet shtesë. Rezultatet e parashikuara: 8-9 të zgjedhur në bazë meritore, 9-14 nga listat shtesë dhe 7 (1/3) prej vendeve të rezervuara. Numri i përgjithshëm prej 21-30 akoma do të mbante Kosovës ndër 20 shtetet e para për kah përfaqësimi i grave.

(b) Zbatimi i rregullës 1/3 për përfaqësim të grave në lista të hapura. Kjo do të mund të ishte problematike meqë shume gra me më pak vota do të mund të zgjedheshin përballë meshkujve me më shumë vota.

| | |
|---|---|
| Ekuilibrimi etnik: | (a) 20 vende të rezervuara (10 për serbët, 10 për pakicat tjera);<br>(b) 10 vende të rezervuara për pakicat tjera<br>(c) pa ulëse të rezervuara (shiko pikën 10) |
| Pragu minimal: | (a) Pragu i natyrshëm (prej 4-8.000 votave)e deri në 1,5% që do të eliminonte 2-3 parti:<br>i. Për partitë etnike të pakicave të mbetet vetëm pragu i natyrshëm dhe kjo mos ti ofrohet partive të shumicës<br>ii. Të aplikohet njësoj ndaj të gjithëve |
| Tjera: | Me përjashtim të personave të zhvendosur, nuk do të kishte votim në mungesë. Do të mund të merreshin parasysh metoda më të lira të votimit me anë të postës. |

## Manësitë

*Sikurse edhe sistemi aktual:*

(a) ka tendencë që të sjellë deri tek qeveritë e koalicionit

*Për dallim nga sistemi aktual:*

(a) Është paksa më i ndërlikuar dhe kërkon një familjarizim më të madh të votuesve dhe të politikanëve me të dhe kërkon pak më tepër edukim për votues. Mirëpo, mund të argumentohet se pasi që kosovarët kanë mësuar të votojnë, mund të arsyetohet një sistem paksa më i komplikuar se ai deri tani (votat e pavlefshme kanë rënë nga 5% në 1,7% nga viti 2000 në 2002). Numri i votave të pavlefshme do të rritej pak, por në Kroaci edhe numri prej 12% nuk konsiderohej brengosës (Danas 2002).

(b) Më i shtrenjtë sesa sistemi i kaluar, por sipas të gjitha gjasave më i lirë nëse administrohet nga institucionet vendore.

## Përparësitë

*Sikurse edhe sistemi aktual:*

(a) Përfaqësim proporcional;
(b) Pak vota të humbura (për shkak të vendeve shtesë);
(c) Përfshirje të pakicave;

*Për dallim nga sistemi aktual:*

(a) Llogaridhënie të drejtpërdrejtë (për shkak të përfaqësimit gjeografik dhe listave të hapura);
(b) Lista gjithëpërfshirëse dhe heterogjene (për shkak të përfaqësimit gjeografik

dhe listave të hapura);
(c) Përfaqësim gjeografik;
(d) E zvogëlon ndikimin e Prishtinës si burim i pushtetit të monopolizuar;
(e) E nxitë demokracinë e brendshme partiake.

## 15. SA DO TË KUSHTOJË?

Zgjedhjet e mbajtuar gjatë tri viteve të kaluara kanë qenë relativisht jo të shtrenjta. Megjithatë, duhet pasur parasysh se meqë ato kanë qenë të organizuara nga OSBE-ja, me një numër shumë të lartë të personelit ndërkombëtar, ato kanë qenë tejet të shtrenjta krahasuar me sa do të kushtonin përndryshe. Edhepse ky punim propozon një sistem pak më të ndërlikuar, çmimi i i të cilit do të fryhet pak për shkak të listave të hapura, shpenzimet mund të sillen në nivel më të ulët sesa në zgjedhjet e deritanishme përmes:

(a) Angazhimit të personelit ndërkombëtar vetëm për vendet e domosdoshme;
(b) Personeli vendor, i paguar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, mund të angazhohet për më pak të holla sesa kur angazhohen nga organizatat ndërkombëtare;
(c) Numër të vogël të personelit të punësuar enkas për zgjedhje (duke e shfrytëzuar përkohësisht personelin nga administrata ekzistuese); shumica e zyrtarëve të intervistuar ndër partitë politike, komisionet komunale të zgjedhjeve dhe shoqërisë civile mendonin se komisionet komunale të zgjedhjeve nuk duhet të kenë mandat të përhershëm (IFES/Thiel 25).
(d) Çmimi për votues duhet të mbetet në rreth 4-5 euro;
(e) Mos të shpenzohet për posterë kolor (mjaftojnë posterët një apo dy-ngjyrësh);
(f) Arsimimi i votuesve do të mund të lehtësonte rendet e pritjes në ditën e votimit.

## 16. SYGJERIMET PËRFUNDIMTARE

a. *Rekomandimi i debatit publik.*
Në Kosovë ka nevojë për një debat të hapur publik për kulturën politike, vlerat normative dhe sistemin shtetëror të cilin qytetarët e saj synojnë të realizojnë, pavarësisht nga zgjidhja e statusit përfundimtar. Debati nuk duhet të përqëndrohet rreth çështjeve teknike të sistemit zgjedhor, por në vlerat demokratike dhe preferencat normative të cilat sistemi zgjedhor tenton të nxitë. Ky diskutim nuk duhet parë si mënyrë që një grup politik të ngadhënjejë ndaj tjetrit, por si hyrje në debatin për vlerat e së ardhmës të cilat synon t'i ushqejë.

b. *Bartja e vendimit në duar të Kuvendit të Kosovës*

Për të arritur zgjidhjen më të mirë dhe për të ndarë ndjenjën e pronësisë dhe të përgjegjësisë, administrata e Kombeve të Bashkuara duhet të bartë çështjen në Kuvendin e Kosovës, por duke ruajtur një prani të fuqishme në përpilimin e ligjit (administrata e Kombeve të Bashkuara duhet të kushtëzojë këtë me arritjen e konsensusit ndërmjet të gjitha forcave politike: LDK-së, PDK-së Koalicionit Kthimi, grupit parlamentar të pakicave josërbe dhe AAK-së) dhe në vëzhgimin e gjithmbarshëm të procesit të zgjedhjeve.

*c. Zëvendësimi i vendeve të rezervuara për serbët me makanizma më të mirë kushtetues.*
Si një pakicë në numër bashkësia sërbe nuk përballet me gjasat për të mos u përfaqësuar fare. Disa vende kanë vënë në zbatim vende të rezervuara vetëm për pakicat të cilat përndryshe do të mbeteshin pa përfaqësim. Për shembull, ligji mbi mosdiskriminimin lehtë do të mund të kishte efekt më të madh sesa dhjetë vende të rezervuara.

*d. Ruajtja e vendeve të rezervuara për pakicat josërbe*
Disa vende të rezervuara megjithatë do të mund të ishin të dobishme për pakicat te cilat nuk rrezikojnë primatin politik të shumicës, e të cilat përndryshe do të mbeteshin pa përfaqësim në parlament.

e. *Nevoja për hulumtim të mëtejmë*
Ky punim mbështetet në disa hulumtime cilësore dhe sasiore, ndonëse, gjerësia dhe thellësia e tij mbetet e kufizuar. Me qëllim të studimit të plotë të variacioneve të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe për të qenë në gjendje që të masim si duhet përparësitë dhe problemet që secili variacion i bartë me vete, vendimmarrësit do të duhej që në duart e tyre të kenë edhe projektet vijuese:

(i) Analizën e pjesëmarrjes së votuesve dhe të trendeve të votimit, të ndarë sipas:
Gjinisë, moshës, kriterit urban/rural, aspektit etnik, mirëqenies sociale/ekonomike, madhësisë së diasporës, të regjistruarve në secilën komunë, madhësisë e secilës komunë, nivelit të arsimit.
(ii) Cilat janë grupet më të brishta?
Personat analfabetë dhe ata me arsim të ulët, gratë, emigrantët, disa nga pakicat, të zhvendosurit dhe refugjatët në vendet e tjera.
(iii) Një analizë profesionale financiare për të vlerësuar se sa do të kushtonte secili nga sistemet zgjedhore
(iv) Efektet psikologjike
Çfarë efekte afatgjate do të ketë ky sistem tek votuesit? Sa kohë do t'u duhet qytetarëve që të mësojnë të votojnë mençur? Në qoftë se e din se kandidati i preferuar nuk ka gjasë për të fituar, sa do të ketë stimulim për të votuar?

# SHTOJCAT

## A. Palët e interesuara:

**Institucionet qeveritare**
- Kuvendi i Kosovës
- Kryetari i Kosovës
- Qeveria e Kosovës

**Administrata ndërkombëtare**
- UNMIK-u, Zyra e PSSP-së
- OSBE, Departamenti i Zgjedhjeve, Grupi Punues për Zgjedhjet

**Partitë politike**
- Të gjitha partitë politike

**Shoqëria civile**
- KMDLNJ, KIPRED, the Forum, KACI, CeSID

**Mediat**
- Gazetarët kryesorë

**Bashkësia ndërkombëtare**
- USAID, NDI, IFES

**Qeveritë lokale**
- Asociacioni i Komunave të Kosovës

## B. Shkurtesat

| | |
|---|---|
| AAK | Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës |
| GPZ | Grupi Punues i Zgjedhjeve (EWG) |
| LDK | Lidhja Demokratike e Kosovës |
| KQZ | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (CEC) |
| NDI | Instituti Kombëtar Demokratik (SHBA) |
| OMiK | Misioni i OSBE-së në Kosovë |
| PDK | Partia Demokratike e Kosovës |
| PSSP | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (SRSG) |

## C. Dokumente relevante për zgjedhjet në Kosovë:

Rezoluta 1244 e Këshilit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 10 qershor 1999
Rregulloret e UNMIK-ut

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/11 (për zgjedhjet komunale në Kosovë) 10 qershor, 2002

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 (Korniza Kushtetuese për Veteqeverisjen e Përkohshme në Kosovë)
Rregullorja e UNMIK-ut 2002/9
Rregullorja e UNMIK-ut 2000/21 (për krijimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve)
Rregullorja e UNMIK-ut 2000/65 (për zgjerimin e kompetencave të Komisionit Qendror Zgjedhor)
Rregullorja e UNMIK-ut 2001/33 (mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës)

Rregullat e OSBE-së për Zgjedhjet; Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KQZ/Rregulla Zgjedhore 1/2002 Kodi i sjelljes për entitetet politike
KQZ/Rregulla zgjedhore 2/2002 Komisionet komunale të zgjedhjeve
KQZ/Rregulla zgjedhore 3/2002 Vëzhguesit e procesit zgjedhor
KQZ/Rregulla zgjedhore 4/2002 Certifikimi i entiteteve politike
KQZ/Rregulla zgjedhore 5/2002 Bërja publike e financave dhe kufijve të shpenzimeve
KQZ/Rregulla zgjedhore 6/2002 Nën-komisionet për ankesa dhe parashtresa
KQZ/Rregulla zgjedhore 7/2002 Informimi i votuesve
KQZ/Rregulla zgjedhore 8/2002
KQZ/Rregulla zgjedhore 9/2002 Komisionet e vendvotimeve
KQZ/Rregulla zgjedhore 10/2002 Mediat gjatë fushatës zgjedhore
KQZ/Rregulla zgjedhore 11/2002 Vendvotimet, qendrat e votimit dhe komitetet e qendrave të votimit
KQZ/Rregulla zgjedhore 12/2002 Procedura e numërimi
KQZ/Rregulla zgjedhore 1/2001 Kodi i sjelljes për entitetet politike
KQZ/Rregulla zgjedhore 2/2001 Nën-komisioni për parashtresa dhe ankesa
KQZ/Rregulla zgjedhore 3/2001 Certifikimi i partive politike, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur
KQZ/Rregulla zgjedhore 4/2001 Komisionet e zgjedhjeve komunale
KQZ/Rregulla zgjedhore 5/2001 Vëzhguesit e zgjedhjeve
KQZ/Rregulla zgjedhore 6/2001 Informata për votuesit
KQZ/Rregulla zgjedhore 7/2001 Mediat gjatë fushatës zgjedhore
KQZ/Rregulla zgjedhore 8/2001 Regjistrimi i kandidatëve
KQZ/Rregulla zgjedhore 9/2001 Komitetet e vend-votimeve
KQZ/Rregulla zgjedhore 10/2001 Publikimi i të dhënave për financat gjatë fushatave dhe kufizimi i shpenzimeve
KQZ/Rregulla zgjedhore 11/2001 Vend-votimet, qendrat e votimit dhe votimi
KQZ/Rregulla zgjedhore 12/2001 Procedura e numërimit

Rregullat procedurale te OSBE-së
Procedurat administrative për komitetet e vend-votimeve dhe mbikqyrësit ndërkomëtarë të vend-votimeve.

## D. Burime nga interneti

Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore: www.ifes.org
Instituti për Demokraci dhe Ndihmë Zgjedhore: www.idea.int
Misioni i OSBE-së në Kosovë: www.osce.org/kosovo
Administrimi dhe çmimi i zgjedhjeve (Projekti ACE):
http://www.aceproject.org/main/english/es/esa.htm
Partitë politike dhe sistemi zgjedhor në Turqi:
http://www.turkey.org/politics/p_electi.htm

## Burimet dhe materiale të rekomanduara për sistemet zgjedhore

Aliu, Lundrim (21 prill 2003). "A po mundohet LDK-ja të ndërrojë edhe sistemin e zgjedhjeve." *Koha Ditore*, Nr. 2096, fq: 1,3.

Aliu, Lundrim (23 prill 2003). "Kuvendi i diskuton zgjedhjet, ndoshta edhe ligjet e kthyera nga Steineri." *Koha Ditore*, Nr. 2098, fq: 2.

Amy, Douglas J. "How Proportional Representation Elections Work"

Barkan, Joel D. (1995). "Elections in Agrarian Societies." *Journal of Democracy* Vëllimi. 6 Nr 4, faqet: 106-116.

Bernard Grofman & Arend Lijphart (1986). "Introduction," Bernard Grofman & Arend Lijphart (ed.), *Electoral Laws and their Political Consequences* New York: Agathon Press.

Bieber, Florian (2003). "Electoral Engineering: The Balkan Record: Managing Interethnic Relations through Elections" (Punimi i prezentuar ne konferencën vjetore të ASN-së, më 3-5 prill 2003).

Bieber, Florian. "Regulating Elections in Post-War Bosnia: Success and Failure of Electoral Engineering in Divided Societies"

Bogaards, Matthijs (2002). "Electoral Systems and the management of Ethnic Conflict in the Balkans," paper presented at the Blue Bird Conference Nation-Building Versus State-Building in the Balkans: Lessons Learned CEU, Budapest nëntorë 30 – 1 dhjetorë.

Caldwell, Andrew (26 mars 2003). Intervistë, Prishtinë (Kryesuesi i departamentit të zgjedhjeve në tranzicion, OSBE Misioni në Kosovë).

Camaj, Lindita (26 prill 2003). "Daci kërkon të vazhdohet puna në projektligjin për zgjedhjet, OSBE-ja thotë se vetë vendos." *Koha Ditore,* nr. 2101, fq. 3.

CeSID, Guide through Electoral Controversies in Serbia (Belgrade: Centar za slobodne izbore i demokratiju, 2000).

CeSID (2002 February). Izborni Zakon i Nacionalne Manjine. Beograd: Centar za slobodne izbore i demokratiju.

Danas, (September 4, 2002). (Hronika). www.danas.co.yu

Douglas W. Rae (1967). The Political Consequences of Electoral Laws.
Election Law, Government Ethics & Lobbying: http://profs.lp.findlaw.com/election/index.html
European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), Electoral Law and National Minorities, Strasbourg, 12.1.1999.
Gashi, Zijadin (23 prill 2003). "Këtë javë Kuvendi debaton për zgjedhjet, kurse për rezolutën për luftën në fillim të majit." *Zëri*, Nr. 1016, Viti V, fq: 3.
Horowitz, Donald (1991). *A Democratic South Aftrica? Constitutional Engineering in a Divided Society*. Berkeley: University of California Press.
Horowitz, Donald (1985). *Ethnic Groups in Conflict* (Berkeley/Los Angeles: University of California Press.
Horowitz, Donald L. (janar 2003). "Electoral Systems and Their Goals: A Primer for Decision-Makers"
ICG (21 nentorë 2001). "Kosovo: Landmark Election" Grupi Internacional i Krizave, Balkan Report Nr. 120, Pristina, Brussels.
ICG (4 mars 1999) "Breaking the Mould. Electoral Reform in Bosnia-Herzegovina." International Crisis Group.
Ilirjani, Altin "Electoral Systems: Summaries." (handouts).
International Almanac of Electoral History
Isufi, Përparim (26 prill 2003). "Udhëheqja e Kuvendit e vendosur të nxjerrë Ligjin për Zgjedhjet." *Zëri*, Nr. 1019, Viti V, fq. 1,3.
Izborni Zakon Bosne i Hercegovine, Slu beni List Bosne i Hercegovine, 23/01, 19.9.2001 (amended version, 3.8.2002)
KACI (2002). "Kosovar Electorate: Profile and Challenges" (Anketë e qytetarve Kosovarë mbi zgjedhjet parlamentare 2001, i referohet anketës mbi zgjedhjet lokale 2000).
Kasapovic, Mirjana (1993). *Izborni i stranaski sustav Republike Hrvatske*. Zagreb: Alinea.
Khazen, Farid el (1994). *Prospects for Lebanon. Lebanon's First Postwar Parliamentary Elections: An Imposed Choice*. London: Centre for Lebanese Studies.
KIPRED--Robert Muharremi, Lulzim Peci, Leon Malazogu, Verena Knaus and Teuta Murati (janar 2003). Administration and Governance in Kosovo: Lessons Learned and Lessons to be Learned. Pristina/Geneva: CASIN (The rehabilitation of war-torn societies: a project co-ordinated by the Center for Applied Studies in International Negotiations.
Kraja, Mehmet. (11 tetor 2002). (Debate), Prishtina.
Lijphart, Arend (1994). Electoral Systems and Party Systems: A Study of Twenty-Seven Democracies, 1945-1990. Oxford, UK: Oxford University Press.
Lijphart, Arend (1991). "Constitutional Choices for New Democracies." *Journal of Democracy* Vëllimi. 2, 72-84.
Lijphart, Arend (1990). "Electoral Systems, Party Systems and Conflict Management in Segmented Societies." In Robert A. Schrire, ed. *Critical Choices for South Africa*. Cape Town: Oxford University Press, faqet: 2-13.
Lijphart, Arend (1994). Electoral Systems and Party Systems: A Study of Twenty-Seven

Democracies, 1945-1990. Oxford, UK: Oxford University Press.

López-Pintor, Rafael (shtator 2000). Electoral Management Bodies as Institutions of Governance. : New York: UNDP, Bureacu for Developmen Policy.

Makolli, Ibrahim (11 tetor 2002). Debate, Klubi Republikan, Prishtina.

Milicevic, Nedjo. Analysis of the Peace Document on Elections, AIM Sarajevo, 28 Janar 1996.

NDI "Building Grassroot Democracy in Kosovo: Conference Report" 2 prill, 2003, Prishtina.

OSCE (8 mars 2001). "Electoral Systems and Representation: Opportunities for Kosovo" (shënime nga seminari) OSBE Misioni në Kosovë.

OSCE (8 nentor 2002). "Explanation of Seat Allocation Formula" OSBE Misioni në Kosovë.

OSCE "Electoral System Option" OSBE Misioni në Kosovë (Power Point Prezentim).

OSCE "Electoral System Recommendation" OSBE Misioni në Kosovë (Power Point Prezentim).

OSCE "Electoral Processes and Stability in Post-Conflict Societies: The Ongoing Experience of Kosovo/Federal Republic of Yugoslavia" OSBE Misioni në Kosovë, Departamenti i operacioneve për zgjedhje (përpiluar nga Peter Erben, Drejtor i operacioneve për zgjedhje dhe Jarret Blanc, Konsultant kryesor i drejtorit të operacioneve për zgjedhje).

OSCE "The choice of an electoral system for Kosovo-wide Assembly elections" (Vështrime mbi sistemet zgjedhore dhe strukturat për të ardhmën në Kosovë, " faqe: 3-21 (nga doracaku i OSBE për seminarin *Sistemet Zgjedhore dhe përfaqsime: Mundësitë për Kosovën*).

OSCE (17shtator 2001). "Summary of the Operational Plan: Voter Registration and Election 2001 (based on Version 6)." Departamenti i operacioneve për zgjedhje. OSBE, Misioni në Kosovë.

Ossipoff, Mike "Systematic Procedures for PR Allocation Formulas (Sainte-Lague & d'Hondt)"

Pavicevic, Veselin (janar 2002). *Izborni sistem: distributivni cinioci izbornog sistema na primeru izbora u Crnoj Gori 1990-2001*. Beograd: CeSID.

Reilly, Benjamin (2001). *Democracy in Divided Societies. Electoral Engineering for Conflict Management*. Cambridge: CUP.

Reilly, Ben and Andrew Reynolds (1999). *Electoral Systems and Conflict in Divided Societies*. (Papers on International Conflict Resoltuion Nr. 12). Washington, D.C.: National Academy Press.

Reynolds, Andrew (1995). "The Case for Proportionality." *Journal of Democracy* Vëllimi. 6 Nr 4, faqe: 117-124.

Reynolds, Andrew (1995). "Constitutional Engineering in South Africa." *Journal of Democracy*, Vëllimi. 6 Nr 2, faqe: 86-99.

Reynolds, Andrew and Ben Reilly (2000). *Manual i International IDEA për hartimin e sistemeve elektorale*. (Seria e manualeve 1/97). Prishtinë: SFINGA.

Reynolds, Andrew "Design Principles."
http://www.aceproject.org/main/english/es/esa.htm

Taagepera, Rein and Matthew Soberg Shugart (1989). *Seats and Votes*. New Haven: Yale University Press.

Roth, Colin "Elections and the electoral process: a guide to assistance" DFID (Issues), Foreign and Commonwealth Office.

Shoup, Paul (janar/shkurt 1997). "The Elections in Bosnia and Herzegovina. The End of an Illusion," *Problems of Post-Communism*, Vëllimi. 44, Nr. 1.

Stein, Michael, Intervistë personale, 10 tetor 2002, Prishtinë.

Schedler, Andreas (prill 2002). "The Menu of Manipulation," *Journal of Democracy*, Vëllimi. 13, Nr. 2.

Tahiri, Ramush (26 mars 2003). Intervistë personale, Prishtinë.

Theil, Hermann (shkurt 2001). "Administrimi dhe Mbajtja e Zgjedhjeve: Konkludime nga Anketa për Zgjedhjet Komuanle të tetorit të vitit 2000 në Kosovë" IFES.

**Shënime**

1. Reynolds, Andrew, http://www.aceproject.org/main/english/es/esa.htm

2. Falenderojmë Donald L. Horowitz, Altin Ilirjani, Florian Bieber, Lulzim Peci dhe Besnik Pulën për komentet shtesë dhe sugjerimet në nivelet e ndryshme të këtij punimi, Isa Blumin për redaktimin në gjuhën angleze dhe Burim Ejupin për iniciimin e këtij projekti si dhe për organizimin e konferencës.

3. Si rrjedhojë e përfshirjes së kufizuar të këtij studimi, çështjet e rëndësishme në vazhdim lidhur me aspektet e organizimit të zgjedhjeve, nuk janë përfshirë në verzionin e tanishëm t këtij punimi: regjistrimi i votuesve, rregulloret mbi financat, neutraliteti i trupit votues, ndërhyrja qeveritare, presioni i pakontrolluar, niveli dhe kualiteti i çasjes në media, objektiviteti dhe mbulimi në media, edukimi i votuesve, çasja në fonde të fushatave, çasja e kandidatëve në elektorat, kualiteti dhe shpërndarja e literaturës për zgjedhje, procesi i nominimit të kandidatëve.

4. Si rezultat i përqëndrimit të këtij punimi mbi Kosovën, nuk elaborohen në detaje të mëtutjeshme përparësitë dhe mangësitë e sistemeve tjera. Për më shumë informata lidhur me këtë çështje, konsultoni manualin IDEA mbi dizajnimin e sistemeve elektorale.

design & prepress: PIKA (www.pikastudio.net)

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

342.84 (496.51) (06)

REFORMIMI i sistemit zgjedhor në Kosovë : Punim disku- tues / [Përpiluar nga Leon Malazogu dhe Ilir Dugolli]. - [Ribotim]. - Prishtinë : KIPRED, 2005 (Prishtinë : „ADD"). - VI, 40 fq.; 24 cm. - (Seria e kërkimeve politike : Botim i veçantë)

Shtojcat : fq.31-35. - Shënime : fq.36

1. MALAZOGU, Leon 2. DUGOLLI, Ilir

**ISBN 9951-14-010-6**

## Për KIPRED-in

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave ka për qëllim të përkrahë vlerat demokratike në Kosovë përmes trajnimeve dhe analizave të pavarura të politikave publike.

Trajnimet kryesisht fokusohen në zhvillimin e partive politike përmes Internet Akademisë për Demokraci, e zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme nga Suedia.

Kërkimet fokusohen në botimin e analizave të pavarura në fusha si qeverisja e mirë, administrata, zhvillimi i partive politike, bashkëpunimi rajonal, politika ekonomike dhe qeverisja lokale.

KIPRED-i financohet nga fondacioni suedez "Olof Palme International Center" dhe nga fondacioni amerikan "Rockefeller Brother's Fund".

KIPRED
Kodra e Diellit, Rr. III, Ll. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Tel/Fax: +381 (0) 38 555 887
Info: kipred@hotmail.com
www.kipredinstitute.org

Përkrahur nga: THE OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER; Rockefeller Brothers Fund — Philanthropy for an Interdependent World

ISBN 9951-14-010-6